



Banka e Shqipërisë

2012

RAPORTI VJETOR  
I MBIKËQYRJES

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.*

*Botuar nga: Banka e Shqipërisë,*

*Sheshi "Avni Rustemi" Nr.24, Tiranë, Shqipëri*

*Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11*

*Faks: + 355 4 2419408*

*E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)*

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

*Tirazhi: 310 kopje*

*Shtypur në shtypshkronjën Albdesign.*

# P Ë R M B A J T J A

MISIONI I MBIKËQYRJES	7
1. AKTIVITETI MBIKËQYRËS GJATË VITIT 2012, NË KUADRIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË MBIKËQYRJES BANKARE, PËR PERIUDHËN AFATMESME 2009 – 2014	9
1.1 Zhvillimi i kuadrit rregullator dhe përafrimi me direktivat e Bashkimit Evropian	10
1.2 Bashkëpunimi me autoritetet ndërkombëtare dhe vendase	10
2. KUADRI RREGULLATIV DHE PROCESI I LICENCIMIT	13
2.1 Kuadri rregullativ	13
2.2 Licencimi	15
3. ANALIZA E ECURISË DHE RREZIQEVE NË SISTEMIN BANKAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA	23
3.1 Mjedisi ekonomik	23
3.2 Zhvillimet kryesore në ecurinë e sistemit bankar	24
3.3 Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës	24
3.4 Aktivitetet dhe pasivitetet	25
3.5 Administrimi i rreziqeve në veprimtarinë bankare	28
3.6 Mjaftueshmëria e kapitalit	41
3.7 Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit	45
3.8 Unionet financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit	49
4. MBIKËQYRJA NË VEND	51
4.1 Ekzaminimet në vend	51
4.2 Parandalimi i pastrimit të parave dhe transparencën	53
5. REGJISTRI I KREDIVË	57
5.1 Informacioni i përgjithshëm	57
5.2 Përfshirja e subjekteve financiare jobanka	58
Aneksi 1. Struktura e Departamentit të Mbikëqyrjes	59
Aneksi 2. Përafrimi i specifikave të bankave në sistemin bankar	60
Aneksi 3. Aktivitetet dhe pasivitetet	61
Aneksi 4. Treguesit bazë financiarë	63
Aneksi 5. Të dhënat për aksionerët e bankave	64
Aneksi 6. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe agjencive bankare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas prefekturave, deri në vitin 2012	65
Aneksi 7. Lista e rregullores të mbikëqyrjes bankare në fuqi, deri në dhjetor 2012	66
Aneksi 8. Banka dhe degë të bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë	69
Aneksi 9. Institucione financiare jobanka	74
Aneksi 10. Unionet e shoqërive të kursim-kreditit	80
Aneksi 11. Zyra të këmbimit të valutorit	90
Aneksi 12. Të dhëna për aksionerët/ortakët e subjekteve financiare jobanka	144

## P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

<b>2 Kuadri rregullativ dhe procesi i licencimit</b>		
Tabelë 1.	Numri i zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vitin 2012.	19
Tabelë 2.	Numri i agjentëve për transferimin e parave deri në fund të vitit 2012.	20
Tabelë 3.	Produktet elektronike bankare të miratuara nga Banka e Shqipërisë (2006 – 2012).	21
Tabelë 4.	Shpërndarja e produkteve / shërbimeve të e-banking sipas bankave në fund të vitit 2012.	21
Tabelë 5.	Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve.	21
Tabelë 6.	Mbulimi me shërbime bankare deri në vitin 2012.	22
Tabelë 7.	Veprimtaritë që kryhen nga subjektet financiare jobanka.	22
Tabelë 8.	Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2012.	22
<b>3 Analiza e ecurisë dhe rreziqeve në sistemin bankar dhe institucionet financiare jobanka</b>		
Tabelë 9.	Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.	25
Tabelë 10.	Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar.	26
Tabelë 11.	Ecuria e zërave kryesorë të pasiveve të sistemit bankar.	26
Tabelë 12.	Ndryshimi i zërave jashtë bilancit gjatë vitit 2012.	27
Tabelë 13.	Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.	27
Tabelë 14.	Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2012.	28
Tabelë 15.	Kredia sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit (në mld lekë).	29
Tabelë 16.	Struktura e tepricës së kredisë sipas afatit, në përqindje.	29
Tabelë 17.	Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhës (në përqindje).	30
Tabelë 18.	Pjesa e pambuluar e kredisë në valutë nga rreziku i kursit të këmbimit (në përqindje).	31
Tabelë 19.	Kredia sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).	31
Tabelë 20.	Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.	32
Tabelë 21.	Llojet e kolateraleve të shpërndara sipas sektorëve dhe monedhave (në përqindje).	35
Tabelë 22.	Ecuria e depozitave për tre monedhat kryesore.	38
Tabelë 23.	Hendeku i maturimit deri në një muaj dhe deri në tre muaj për sistemin bankar.	39
Tabelë 24.	Ecuria e treguesit kredi ndaj depozitave, në përqindje.	40
Tabelë 25.	Struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij.	42
Tabelë 26.	Ecuria e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut të sistemit bankar.	43
Tabelë 27.	Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë, në përqindje (kumulative).	44
Tabelë 28.	Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore, në përqindje (kumulative).	44
Tabelë 29.	Treguesit mesatarë të përfitueshmërisë, në milionë lekë.	45
Tabelë 30.	Ecuria e treguesit të efikasitetit në milionë lekë.	45
Tabelë 31.	Totali i aktiveve të SFJB-ve të ndara sipas aktivitetit kryesor të tyre, për periudhën dhjetor 2011 - dhjetor 2012 (në miliardë lekë).	46
Tabelë 32.	Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e SFJB-ve për periudhën dhjetor '11 - dhjetor '12, në miliardë lekë.	47
Tabelë 33.	Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë për periudhën dhjetor '11 - dhjetor '12 (në përqindje).	48
Tabelë 34.	Ecuria e numrit të SHKK-ve dhe anëtarësimeve, për periudhën dhjetor '11 - dhjetor '12.	49
Tabelë 35.	Ecuria e aktiveve të unioneve dhe rrjetit të SHKK-ve për periudhën dhjetor '11 - dhjetor '12 (në miliardë lekë).	49
Tabela 36.	Ecuria e portofolit të kredisë bruto dhe neto, për totalin e unioneve dhe rrjetit të SHKK-ve për periudhën dhjetor '11 - dhjetor '12 (në miliardë lekë).	49
<b>5 Regjistri i Kredive</b>		
Tabela 37.	Numri i kredive aktive të raportuara në Regjistrin e Kredive.	57
Tabela 38.	Numri i kërkimeve në Regjistrin e Kredive nga subjektet raportuese.	57
Tabela 39.	Numri i kërkimeve për raporte kredimarrësish dhe i atyre për rishikim të dhënash pranë Bankës së Shqipërisë.	58

## P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

**2 Kuadri rregullativ dhe procesi i licencimit**

Grafik 1.	Struktura e sektorit bankar dhe financiar.	15
Grafik 2.	Ecuria e degëve/agjencive të bankave në vite.	18
Grafik 3.	Shpërndarja gjeografike e popullsisë banuese (1) dhe rritit të degëve/agjencive të bankave (2), sipas prefekturave.	18
Grafik 4.	Ecuria e zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vite.	19
Grafik 5.	Shpërndarja gjeografike e zyrave të këmbimit valutor në vitin 2012.	19

**3 Analiza e ecurisë dhe rreziqeve në sistemin bankar dhe institucionet financiare jobanka**

Grafik 6.	Struktura e pronësisë së kapitalit të sistemit bankar, në fund të vitit 2012.	25
Grafik 7.	Ecuria e rritjes mujore të kredisë gjatë vitit 2012 (në përqindje).	28
Grafik 8.	Teprica e kredisë akorduar biznesit dhe individëve ndaj tepricës totale të kredisë (në përqindje).	29
Grafik 9.	Vëllimi i tepricës së kredisë sipas afateve (në mld lekë) majtas; Vëllimi i tepricës së kredisë sipas monedhave (në mld lekë) djathtas.	30
Grafik 10.	Rritja e portofolit të kredive me probleme dhe e portofolit të kredive (në përqindje).	32
Grafik 11.	Ecuria e tepricës së kredisë me probleme në sistemin bankar.	32
Grafik 12.	Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë me probleme.	33
Grafik 13.	Teprica e kredisë me probleme për bizneset dhe individët.	33
Grafik 14.	Teprica e kredisë me probleme sipas monedhave.	33
Grafik 15.	Ecuria 3-mujore e raportit "kredi me probleme në valutë /teprica e kredisë në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit" për vitin 2012.	33
Grafik 16.	10, 20, 50 dhe 100 kredimarrësit më të mëdhenj të sistemit, në përqindje ndaj tepricës së kredisë së sistemit (31 dhjetor 2012).	34
Grafik 17.	Shpërndarja e vëllimit të kredisë së 10 kredimarrësve më të mëdhenj sipas klasifikimit.	34
Grafik 18.	Niveli i mbulimit të kredive me kolateral sipas llojeve.	35
Grafik 19.	Ecuria e depozitave të klientëve (në miliardë lekë).	37
Grafik 20.	Struktura e depozitave sipas maturitetit të mbetur.	37
Grafik 21.	Ecuria e aktiveve likuide, strukturës së zërave përbërës së tyre dhe treguesit të likuiditetit.	38
Grafik 22.	Struktura e aktiveve likuide sipas monedhave.	39
Grafik 23.	Hendeku i maturimit deri në tre muaj sipas monedhave, si dhe hendeku sipas shportave të maturitetit.	39
Grafik 24.	Ecuria e kapitalit aksioner.	42
Grafik 25.	Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe komponentëve të saj.	42
Grafik 26.	Kredia me probleme neto / kapitali rregullator.	43
Grafik 27.	Zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik.	44



## MISIONI I MBIKËQYRJES

Funksioni i mbikëqyrjes ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar, dhe të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nr. 9662, datë 18.12.2006, i ndryshuar. Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj:

- synon të sigurojë veprimtari të shëndoshë bankare duke hartuar dhe zbatuar politika dhe një kuadër rregullator të përshtatshëm, fleksibël dhe në linjë me dinamikat e zhvillimit në vend, me qëllim ruajtjen e shëndetit të bankave, të stabilitetit të sistemit bankar e më gjerë, parandalimin e krizave në këtë sektor, si dhe mbrojtjen e depozituesve;
- ndikon në stabilitetin e sistemit bankar dhe më gjerë, duke monitoruar zhvillimet në treg dhe rekomanduar masat e nevojshme, në mënyrë që subjektet e mbikëqyrura t’iu përshtaten këtyre zhvillimeve dhe të administrohen në vazhdimësi sipas praktikave më të mira;
- nxit disiplinën e tregut, duke kërkuar rritjen e transparencës për produktet dhe shërbimet bankare e financiare;
- ndikon në zhvillimin e një konkurrence të ndershme ndërmjet subjekteve të mbikëqyrura dhe synon të sigurojë trajtimin e barabartë të subjekteve të licencuara dhe të klientëve të tyre, në përputhje me politikat përkatëse mbikëqyrëse dhe rregullat në fuqi. Në këtë kontekst, prirjet nga parimi se llojet e ngjashme të rreziqeve financiare dhe çështje të tjera relevante të rregullimit duhet t’i nënshtrohen të njëjtave rregulla në të gjitha segmentet e tregut për të kufizuar mundësitë për arbitrazh rregullator.

Banka e Shqipërisë e realizon funksionin e saj mbikëqyrës, nëpërmjet:

- a) ndërtimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator mbikëqyrës, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me direktivat evropiane për një mbikëqyrje efektive, me specifikat e vendit, si edhe në zbatim të praktikave më të mira;
- b) rregullimit të hyrjes në treg të bankave potenciale, aksionerëve dhe administratorëve, me reputacion të mirë, bazuar në burime informacioni të verifikueshme dhe të besueshme;

- c) ndjekjes së një procesi mbikëqyrës efektiv dhe proaktiv duke zbatuar parime të një mbikëqyrjeje të orientuar nga rreziku nëpërmjet inspektimeve në vend dhe analizës së vazhdueshme në distancë të treguesve të subjekteve të licencuara, si edhe ndërmarrjes së veprimeve korrektuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
- d) bashkëpunimit me subjektet e mbikëqyrura, me institucione të tjera financiare brenda vendit, si edhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse e bankat e huaja që kanë hapur degë ose filialin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në zbatimin e kërkesave të funksionit mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë synon nivelet më të larta të integritetit, të profesionalizmit, të eficiencës, të transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse.



## 1. AKTIVITETI MBIKËQYRËS GJATË VITIT 2012, NË KUADRIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË MBIKËQYRJES BANKARE, PËR PERIUDHËN AFATMESME 2009 – 2014

Veprimtaria mbikëqyrëse gjatë vitit 2012 është karakterizuar nga një kontroll i shpeshtuar në vend i veprimtarisë bankare duke ruajtur një koordinim sa më të balancuar midis qasjes së bazuar në rrezik, pra rreziqeve të evidentuara, si dhe burimeve në dispozicion. Zhvillimet financiare ndërkombëtare, veçanërisht në tregjet e lidhura me ekonominë e vendit, si dhe faktorët e brendshëm të zhvillimit kanë sjellë nevojën për më tepër vëmendje të mbikëqyrjes ndaj veprimtarisë financiare në tërësi dhe asaj bankare në veçanti.

Si rezultat i zhvillimeve të vitit 2012, veprimtaria e mbikëqyrjes bankare është bazuar në një proces analitik të kujdesshëm, duke shtuar variablat e marrë në konsideratë gjatë procesit të analizës si dhe thelluar arsyetimin, kombinimin dhe efektet e tyre mbi ecurinë e sistemit bankar. Tërësia e variablave të marrë në konsideratë ka qenë e lidhur me një sërë faktorësh ekonomikë, rregullativë dhe institucionalë, të jashtëm e të brendshëm. Informacioni i grumbulluar është shfrytëzuar për të krijuar skenarë analizash me fleksibilitet të mjaftueshëm ndaj situatave, të cilat janë vlerësuar të mundshme për t'u shfaqur në të ardhmen.

Rezultatet e analizave janë përkthyer në veprime mbikëqyrëse, në identifikim të nevojave për rregullim apo orientim të zhvillimeve të pjesëmarrësve të tregut, si dhe në identifikim të nevojave për zhvillime të kapaciteteve të brendshme.

Komunikimi me pjesëmarrësit e tregut financiar ka zënë një vend të veçantë, duke u karakterizuar nga dialog intensiv në çdo nivel menaxhimi, si për të njohur praktikat mbikëqyrëse dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen, ashtu edhe për risjelljen në vëmendje të peshës që ka çdo pjesëmarrës i tregut.

Filozofia mbikëqyrëse e ndjekur gjatë vitit 2012 është mbështetur në elementët kryesorë të përcaktuar në strategjinë afatmesme të zhvillimit të mbikëqyrjes, duke thelluar më tej kuptimin e tyre, për zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore, të metodologjisë së analizës dhe të kuadrit rregullator, për bashkëpunimin e ngushtë me autoritetet ndërkombëtare.

## 1.1 ZHVILLIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE PËRAFRIMI ME DIREKTIVAT E BASHKIMIT EVROPIAN

Harmonizimi i kuadrit tonë rregullator me standardet evropiane në fushën e mbikëqyrjes vijoi të jetë në fokus të Departamentit të Mbikëqyrjes edhe gjatë vitit 2012. Kështu, gjatë këtij viti u finalizua projekti i rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili në periudhat në vazhdim do të konsultohet me industrinë bankare. Paralelisht me punën për hartimin e kësaj rregulloreje, një vëmendje e veçantë iu kushtua përpilimit të kuadrit raportues pranë Bankës së Shqipërisë, bazuar në standardin COREP, të hartuar nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA).

## 1.2 BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET NDËRKOMBËTARE DHE VENDASE

### 1.2.1 BASHKËPUNIME AUTORITETET NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi me autoritetet e huaja ka vijuar edhe gjatë vitit 2012. Kështu, ky vit shënoi finalizimin e projektit të binjakëzimit me Bankën e Italisë, në kuadrin e të cilit, Banka e Shqipërisë (BSH) në mënyrë të veçantë forcoi kapacitetet e saj mbikëqyrëse, si dhe zhvilloi më tej metodologjinë e vlerësimit të rreziqeve. Projekti u kurorëzua me një sërë produktesh, përfshirë manualët e rishikuara të mbikëqyrjes, të hartuara në bazë të parimeve të shtyllës II të Bazelit dhe eksperiencës së Bankës së Italisë në fushën e mbikëqyrjes bankare. Nga ana tjetër, edhe një sërë rregulloresh në rishikim e sipër nga Banka e Shqipërisë, përfituan nga asistenca teknike e marrë në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Italisë. Në terma të kapaciteteve njerëzore, një varg trajnimesh të realizuara si nëpërmjet misioneve të ekspertëve të Bankës së Italisë pranë BSH, ashtu edhe nëpërmjet vizitave studimore të stafit të BSH në Bankën e Italisë, kontribuan në përsosjen e mëtejshme të njohurive të një pjese të konsiderueshme të punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes mbi mbikëqyrjen bankare dhe rregullimin në përputhje me standardet e BE-së.

Bashkëpunimi ka vijuar edhe me Financial Services Volunteer Corps (FSVC) gjatë vitit 2012 dhe është përqendruar në prioritetet e përcaktuara nga axhenda e ngjeshur e BSH-së në fushën e mbikëqyrjes. Kështu, në bashkëpunim edhe me Bundesbank, gjatë këtij viti u organizua një seminar disaditor me pjesëmarrje të gjerë të Departamentit të Mbikëqyrjes, mbi Bazel II dhe direktivën evropiane mbi kërkesat e kapitalit. Po kështu, bashkëpunimi ka mbuluar edhe fushën e administrimit të rrezikut të kredisë, nëpërmjet trajnimeve të posaçme të organizuara me pjesëmarrjen e Federal Deposit Insurance Company (FDIC). Me pjesëmarrjen e Banking Regulation and Supervision Agency (BRSA) u organizua një tjetër seminar mbi mbikëqyrjen e kompanive të *leasing*-ut dhe *factoring*-ut.

Mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit me autoritetin mbikëqyrës të Bankës së Serbisë janë shkëmbyer eksperiencia në kuadër të masave për

parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Ndërkohë, bashkëpunimi me autoritetet e huaja ka përfshirë edhe takime apo pjesëmarrje në aktivitete trajnuese të organizuara në kuadër të projektit të binjakëzimit të Njësisë së Inteligjencës Financiare Spanjolle, me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Prokurorinë e Përgjithshme Shqiptare etj.

Përveç sa më sipër, mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa autoritete mbikëqyrëse të huaja janë shkëmbyer informacione për banka të caktuara, filialet e të cilave zhvillojnë aktivitete bankare në vendin tonë. Gjithashtu, në vijim të iniciativës së Bankës Qendrore Evropiane për funksionimin e kolegjeve të mbikëqyrësve të institucioneve më të mëdha bankare e financiare evropiane, gjatë vitit 2012, është marrë pjesë në kolegjet e organizuara nga Banka e Greqisë.

Së fundmi, Banka e Shqipërisë ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. Në këtë kuadër, shkëmbimi i informacionit ka qenë i vazhdueshëm dhe në funksion të identifikimit më të mirë të sfidave me të cilat përballen mbikëqyrja. Në përgjigje të këtyre sfidave e sidomos duke u përqendruar në adresimin e çështjes së cilësisë së portofolit të kredisë në sistemin bankar, vlen të përmendet në mënyrë të veçantë bashkëpunimi me Bankën Botërore për të hedhur bazat e një bashkëpunimi afatmesëm me qëllim krijimin e kushteve për uljen e kredive me probleme në veprimtarinë bankare.

### 1.2.2 BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET VENDASE

Ndër bashkëpunimet e ngushta të këtij viti, përmendim për të disatin vit radhazi atë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), kryesisht në luftën kundër krimit financiar në kuadër të zbatimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar". Ky bashkëpunim ka përfshirë edhe një shkëmbim korrespondence të shpeshtë gjatë gjithë vitit midis Bankës së Shqipërisë dhe DPPPP-së. Si momente të veçanta, përmendim rritjen e numrit dhe shtimin e efektivitetit të:

- Inspektimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta në funksion të forcimit të kapaciteteve profesionale mbikëqyrëse dhe shkëmbimit të eksperiencave të ndryshme;
- Trajnimeve të subjekteve me qëllim përsosjen e ushtrimit të veprimtarive përkatëse përkundrejt përmbushjes së detyrimeve ligjore;
- Implementimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me strategjinë e luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve, terrorizmit, etj.

Përmendim këtu se përgjatë vitit 2012, janë kryer gjithsej 8 inspektime të përbashkëta me DPPPP si dhe 3 raunde trajnimesh të përbashkëta në Tiranë, për zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jobanka.

Bashkëpunimi është shtrirë edhe në nivel ndërinstitucional. Përmendim këtu bashkëpunimin e BSH-së në Grupin ndërinstitucional të punës, krijuar

me urdhër të Kryeministrit Nr. 46, datë 10.04.2012 për ngritjen e Grupit ndërinstitucional të punës, për hartimin e ndryshimeve në ligjin 9917 datë 19.05.2008, i ndryshuar, për përmbushjen e Rekomandimeve të Financial Action Task Force (FATF) dhe vlerësimit të raundit IV të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës për Shqipërinë. Gjithashtu, bashkëpunim ka patur edhe me institucione të ndryshme, të cilat monitorojnë aktivitetet të veçanta të tregut financiar. Me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, janë shkëmbyer informacione dhe janë kryer inspektime të përbashkëta që prekin shoqëritë e sigurimeve dhe marrëdhëniet e këtyre të fundit me autoritetin mbikëqyrës, në një bankë. Bashkëpunimi ka qenë i ngushtë edhe me institucione të tjera si Ministria e Financave, Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB), Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

## 2 KUADRI RREGULLATIV DHE PROCESI I LICENCIMIT

### 2.1 KUADRI RREGULLATIV

Gjatë vitit 2012, vazhdoi puna për hartimin e disa rregulloreve të reja dhe të disa ndryshimeve në rregullore të tjera të mbikëqyrjes bankare. Procesi i rishikimit të kuadrit rregullativ mbikëqyrës u realizua në vazhdimësi në përputhje me standardet e Komitetit të Bazelit dhe direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe duke konsideruar praktikën më të mira në fushën e rregullimit dhe zhvillimet në sistemin bankar shqiptar.

Hartimi dhe rishikimi i rregulloreve të mbikëqyrjes bankare vazhdoi të realizohet nëpërmjet grupeve të punës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve jo vetëm të Departamentit të Mbikëqyrjes, por edhe të përfaqësuesve të Departamentit Juridik, të Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, Departamentit të Stabilitetit Financiar, Departamentit të Sistemeve të Pagesave, si dhe në çdo rast mbart mendimin e industrisë bankare dhe të subjekteve të tjera financiare.

Viti 2012 finalizoi hartimin e disa rregulloreve të reja dhe njohu ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes bankare.

#### 1. Akte të reja rregullative me rëndësi për mbikëqyrjen bankare

- Rregullorja “Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë” (miratuar me vendimin nr. 27, datë 16.05.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë) përcakton rregullat mbi procesin e krijimit, licencimit dhe funksionimit të bankës urë. Hartimi i rregulloreve të reja lindi si domosdoshmëri nga ndryshimet e fundit të ligjit për bankat, të cilat prezantuan për herë të parë konceptin e bankës urë, duke diktuar njëkohësisht nevojën për rregullimin e këtyre proceseve (krijim, licencim dhe funksionim) me akt nënligjor të veçantë, mbështetur në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e administrimit dhe shpëtimit të bankave me probleme.
- Rregullorja “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre” (miratuar me vendimin nr. 63, datë 14.11.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Rishikimi tërësor i rregulloreve

ekzistuese synoi përsosjen dhe rregullimin e mëtejshëm të kërkesave të autoritetit mbikëqyrës lidhur me procesin e drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja, kryesisht në aspektet që fokusojnë sistemet e administrimit të rrezikut dhe strukturat përkatëse, politikat e shpërblimit etj. Shtysë kryesore për rishikimin e këtij akti rregullativ u bënë mësimet e krizës së fundit të vitit 2008, të cilat nxorën në pah domosdoshmërinë e rishikimit të disa aspekteve të qeverisjes së bankave, duke synuar dhe përshtatjen me parimet e rishikuara të Komitetit të Bazelit për qeverisjen e përgjegjshme të bankave.

## 2. Ndryshimet në kuadrin rregullativ

- Një shtesë u realizua në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë” (miratuar me vendimin nr. 28, datë 16.05.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Shtesa në këtë akt rregullativ synoi përfshirjen dhe rregullimin e mëtejshëm të ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime edhe për bankat dhe/ose degët e bankave të huaja, si një veprimtari financiare që kërkon miratim paraprak nga autoriteti mbikëqyrës dhe parashikohet në dispozitat e ligjit për sigurimet<sup>1</sup>.

Bankat dhe degët e bankave të huaja, përveç sa parashikohet në ligjin për bankat, lejohet të kryejnë edhe veprimtari të tjera financiare (të parashikuara nga ligje të posaçme/veçanta), për shembull të fushës së sigurimeve. Pikërisht, për të rregulluar dhe gjithëpërfshirë në kuadrin tonë rregullativ edhe këto veprimtari u realizua shtesa përkatëse në rregulloren që ka si objekt licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja.

- Disa shtesa dhe ndryshime u realizuan në rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare” (miratuar me vendimin nr. 54, datë 12.09.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Ndryshimet synuan plotësimin dhe përditësimin e procesit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive të bankave dhe subjekteve të tjera që licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, sipas niveleve/hierarkisë së përcaktuar në matricën e parashikuar në këtë rregullore.

Rishikimi i matricës së vendimmarrjes, si pjesë integrale e rëndësishme e procesit të licencimit dhe mbikëqyrjes, mori shtysë kryesisht nga disa ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullativ mbikëqyrës apo dhe të shqetësimeve të rezultuara gjatë procesit mbikëqyrës.


<sup>1</sup> Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” (referuar për thjeshtësi “ligji për sigurimet”), i ndryshuar.

- Po kështu, disa shtesa dhe ndryshime u realizuan edhe në rregulloren “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” (miratuar me vendimin nr. 55, datë 12.09.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), të cilat synuan që ndryshimet në rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare” të ecin në të njëjtin drejtim (të mos kenë kundërshti), në funksion të lehtësimit, përsheptimit dhe efektivitetit të procesit të vendimmarrjes.

## 2.2 LICENCIMI

Struktura e sistemit bankar dhe financiar në fund të vitit 2012 përbëhet nga 16 banka tregtare, 21 subjekte financiare jobanka, 1 zyrë përfaqësimi e bankës së huaj, 322 zyra të këmbimit valutor, 126 shoqëri të kursim-kreditit dhe 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit. Sipas origjinës së kapitalit në strukturën e sistemit bankar, 13 banka janë me kapital privat tërësisht të huaj dhe 3 banka me kapital privat të huaj dhe vendas (siç tregohet në grafikun 1). Ndërkohë, në strukturën e subjekteve financiare jobanka, 5 subjekte financiare jobanka janë tërësisht me kapital privat të huaj, 3 subjekte janë me kapital privat të huaj dhe vendas, 2 subjekte janë me kapital publik vendas dhe 11 subjekte me kapital privat vendas. Zyrat e këmbimit valutor dhe shoqëritë e kursim-kreditit janë në pronësi private vendase.

Grafik 1. Struktura e sektorit bankar dhe financiar.



Në zbatim të ligjit për bankat dhe të kuadrit rregullativ, Banka e Shqipërisë si autoriteti licencues dhe mbikëqyrës për bankat, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, dhe zyrat e këmbimit valutor merr vendime që lidhen me:

- dhënien ose revokimin e licencave të bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit e unioneve të tyre dhe zyrave të

- këmbimit valutor,
- miratimin e shndërrimit të degëve të bankave të huaja në filial/bankë vendase,
- miratimin e bashkimit/ndarjes midis bankave në vend,
- miratimin e bashkimit të bankave me subjekte financiare jobanka,
- miratimet paraprake për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë, të papërfshira në aneksin e licencës, nga bankat dhe subjektet financiare jobanka,
- miratimet paraprake për transferimin e pronësisë së aksionerëve me pjesëmarrje influencuese ose kontrollit të bankës/subjektit financiar jobankë të një palë e tretë,
- miratimet paraprake për emetimin e detyrimeve të varura dhe shlyerjen e tyre,
- miratime paraprake të statutit të bankës si dhe të çdo ndryshimi të tij,
- miratimet paraprake të administratorëve të bankave dhe të subjekteve financiare jobanka,
- miratimet paraprake për zgjerimin e rrjetit të bankave,
- miratimet paraprake për kryerjen e veprimtarisë së agjentit për transferimin e parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë,
- njoftime të bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara.

Gjatë vitit 2012, u licencuan rishtas edhe dy subjekte financiare jobanka, duke e çuar në 21 numrin e subjekteve financiare jobanka që operojnë në vend. Dy subjektet jobanka të pajisura me licencë nga Banka e Shqipërisë, janë: "Platinum Investment" sh.p.k. dhe "Zig Factoring" sh.p.k., të cilat ofrojnë përkatësisht veprimtarinë e shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimeve të tjera ndihmëse për këmbimin valutor (Platinum Investment sh.p.k) dhe veprimtarinë e faktoringut (Zig Factoring). Ndërkohë vlen të përmendim që deri në muajin mars të vitit 2013, u finalizua dhënia e licencave për kryerjen e veprimtarisë së faktoringut edhe për dy shoqëri të tjera: "Balcan Factors Albania" sh.a. dhe "Profactoring Albania" sh.p.k., si dhe u vendos revokimi i licencës për mosfillim aktiviteti për subjektin "Zig Factoring" sh.p.k, duke e çuar në total në katër numrin e subjekteve financiare jobanka të cilat operojnë në fushën e faktoringut. Për një periudhë tremujore (20.06.2012 deri 01.10.2012) u pezullua me kërkesë të vetë subjektit financiar jobankë, "M-PAY" sh.p.k, licenca e tij për të ushtruar veprimtari financiare, ndërkohë që pas kësaj periudhe licenca u bë efektive dhe subjekti vepron në treg duke ushtruar veprimtarinë për të cilën është licencuar. Gjithashtu në kuadër të ndryshimeve në ligjin për bankat në drejtim të njohjes së institucioneve të parasë elektronike dhe më vonë me plotësimet në kuadrin rregullator, disa subjekte kanë shprehur interesin për të kryer veprimtarinë financiare të emetimit të parasë elektronike.

Viti 2012 u shoqërua edhe me ristrukturimin e sistemit bankar si rrjedhojë e miratimit të shndërrimit të dy degëve të bankave të huaja që operonin në vend në banka vendase. Kështu, u finalizua licencimi i Bankës Alpha Albania sh.a. dhe Bankës NBG Albania sh.a. për të vepruar si banka në Shqipëri. Përfundimi i këtij transaksioni u konsiderua tepër i rëndësishëm për kohën



në të cilën ndodhi, pasi të dyja degët e bankave origjinonin kapital grek dhe ishin të ekspozuara ndaj rrezikut të bankave mëmë të përfshira në kolapsin e tregjeve financiare në Greqi.

Në funksion të zgjerimit të aktivitetit bankar, bankat kanë vijuar kërkesat për shtimin e veprimtarive në anekset e licencave, si dhe të ofrimit të shërbimeve të reja bankare dhe financiare edhe gjatë vitit 2012. Konkretisht, u paraqitën kërkesa nga Banka Raiffeisen sh.a. dhe Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., përkatësisht për veprimtarinë e faktoringut dhe financimit të transaksioneve tregtare (BR) dhe veprimtarinë e ofrimit të shërbimit të kasave të sigurimit (BISPA), veprimtari të cilat u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Ndërkohë, bankat vazhduan përpjekjet edhe në drejtim të ofrimit të shërbimeve elektronike bankare si dhe përmirësimeve teknologjike nëpërmjet kanaleve shtesë të komunikimit elektronik. Banka Union sh.a. ofroi për klientët e saj shërbimin *mobile banking*, duke e çuar në nivel sistemi në katër numrin e bankave që e ofrojnë këtë shërbim, ndërsa Banka Societe Generale Albania<sup>2</sup> sh.a. njoftoi ofrimin e shërbimit *SMS banking* dhe MasterCard Business për klientët e saj.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të miratimeve për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese në strukturën e aksionerëve të bankave, gjatë vitit 2012 dha për Bankën Raiffeisen sh.a. dhe Bankën Emporiki Shqipëri miratimin për transferimin 100% të pronësisë së aksioneve të tyre. Konkretisht, për Bankën Raiffeisen sh.a. u dha miratimi për transferimin 100% të pronësisë nga Raiffeisen Bank International AG, Austri, tek Raiffeisen SEE Holding Regional GmbH, Austri. Ky transferim u krye në kuadrin e krijimit të tre rajoneve gjeografike në formën e tre shoqërive, 100% filiale të Raiffeisen Bank International AG (RBI). Transaksioni nuk ndryshon kontrollin, menaxhimin dhe pronësinë nga pikëpamja ekonomike të Bankës Raiffeisen sh.a. Ndërkohë për Bankën Emporiki Shqipëri u dha miratimi për transferimin 100% të pjesëmarrjes influencuese nga Emporiki Bank of Greece tek IUB Holding, Francë një filial i drejtpërdrejtë dhe i zotëruar plotësisht nga CASA Group Francë një nga grupet më të fuqishme bankare në Evropë. Ky ndryshim në pronësinë e Bankës Emporiki Shqipëri ndikoi pozitivisht duke rritur prezencën e kapitalit francez në vend dhe u shoqërua edhe me kërkesën për ndryshimin e emrit të bankës në Banka Credit Agricole Shqipëri, për të cilën Banka e Shqipërisë dha miratimin e saj. Gjithashtu gjatë vitit 2012 u ndërmor për herë të parë bashkimi me përthithje midis Bankës Societe Generale Albania sh.a. (shoqëria përthithëse) dhe subjektit financiar jobankë Sogelease Albania sh.a. (shoqëria e përthithur) e zotëruar në masën 100% nga Banka Societe Generale Albania, proces i cili u finalizua me dhënien e miratimit paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në muajin janar 2013. Kërkesa e iniciuar nga Banka Societe Generale sh.a. erdhi në kuadër të riorganizimit të saj dhe mundësisë për një rritje të këtij aktiviteti brenda strukturave të bankës.

Në vitin 2012 u paraqit kërkesa dhe u dha miratimi i Bankës së Shqipërisë për transferimin e pronësisë së ortakut/aksionerit me pjesëmarrje influencuese

<sup>2</sup> Banka ka ngritur infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e shërbimit *mobile banking* dhe është në pritje të miratimit nga Banka e Shqipërisë përgjatë vitit 2013.


te një palë e tretë për subjektin financiar jobankë “Fin-Al” dhe “Albanian Factoring Services”.

Gjithashtu, miratime u dhanë nga Banka e Shqipërisë për emetimin e borxhit të varur nga bankat si dhe shlyerjen e tij, pjesë e burimeve të përhershme të saj dhe element i kapitalit shtesë. Konkretisht pati dy raste miratimi për emetimin e borxhit të varur nga bankat dhe një rast miratimi për shlyerjen e tij. Pjesë e punës së licencimit ishin edhe miratimet e statuteve të bankave tregtare dhe ndryshimeve të ndodhura në to. Gjatë vitit u miratuan ndryshimet në statutin e 10 bankave tregtare.

Ndryshimet në përbërjen e këshillave drejtuese, të komiteteve të kontrollit, të drejtuesve të përgjithshëm ekzekutivë dhe të drejtuesve ekzekutivë të bankave, vijuan gjatë gjithë vitit 2012. Në 39 raste të miratimeve paraprahe të dhëna nga Banka e Shqipërisë për administratorët e bankave dhe të subjekteve financiare jobanka, 10 prej tyre ishin për anëtarë të këshillit drejtues të bankës, 6 raste për anëtarë të komitetit të kontrollit, 3 raste për drejtorë të përgjithshëm, 20 raste për drejtues ekzekutivë dhe 1 rast për miratim administratori për subjekt financiar jobankë.


Zgjerimi i rrjetit të degëve dhe agjencive bankare brenda vendit vijoi me ritme të ulëta rritjeje përgjatë vitit 2012. Konkretisht gjatë këtij viti, rrjeti bankar u zgjerua në total edhe me 4 degë/agjenci të reja si rrjedhojë e miratimeve të dhëna për hapjen e degëve/agjencive të reja, si dhe njoftimeve për mbyllje dege/agjencie nga bankat. Gjithashtu leje u dhanë nga Banka e Shqipërisë edhe për rastet e zhvendosjes së degëve/agjencive të bankave. Në fund të vitit 2012, bazuar në miratimet e dhëna,

Grafik 2. Ecuria e degëve/agjencive të bankave në vite.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Shpërndarja gjeografike e popullsisë banuese (1) dhe rrjetit të degëve/agjencive të bankave (2), sipas prefekturave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

bankat ushtrojnë veprimtarinë me 538 degë/agjenci të hapura brenda territorit të vendit dhe 1 degë<sup>3</sup> që ushtron aktivitetin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga 534 degë/agjenci që vepronin vitin e kaluar brenda vendit dhe 1 degë jashtë vendit.

Shpërndarja e degëve/agjencive bankare përshin aktualisht pothuajse të gjithë territorin e vendit. Evidentohet që përqendrimi më i madh i degëve dhe agjencive bankare është në Tiranë (40%), ku edhe përqendrimi i popullsisë<sup>4</sup> është më i madh (26.97%). Mbështetur në të dhënat e popullsisë urbane, konstatohet që shpërndarja e rrjetit të degëve të bankave është në përpjesëtim me shpërndarjen gjeografike të kësaj popullsie.

Në drejtim të kërkesave të aktorëve të tregut për kryerjen e veprimtarisë së këmbimit valutor, gjatë vitit 2012 u konstatua rritje e kërkesave për hapjen e zyrave të këmbimit valutor krahasuar me një vit më parë. Pavarësisht rritjes, vlen të theksohet se krahasuar me efektin e një rritjeje të vullshme të numrit të zyrave të këmbimit të licencuara gjatë viteve të kaluara, dy vitet e fundit numri i kërkesave paraqet ritme të ulëta rritjeje, me 26 licenca të reja për vitin 2012, të akorduara nga Banka e Shqipërisë. Në harkun kohor 1999<sup>5</sup>-2012, periudhë gjatë të cilës shtrihet edhe kryerja e veprimtarisë së këmbimit valutor nga subjekte të licencuara nga Banka e Shqipërisë, evidentojmë se viti 2008 dhe viti 2010 vazhdojnë të mbeten vitet që shënuan edhe rritjen më të madhe të hyrjeve të aktorëve të rinj në tregun e këmbimit valutor, çka u materializua përkatësisht me 77 dhe 63 licenca të reja.

Theksojmë se të gjitha aplikimet e ardhura nga subjektet gjatë vitit 2012, u finalizuan me dhënien e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor nga Banka e Shqipërisë. Miratime u dhanë edhe për kërkesat e zyrave të këmbimit valutor të licencuara më parë, për zgjerimin e veprimtarisë së tyre nëpërmjet hapjes së zyrave të reja si dhe punësimit të kambistëve të rinj. Me kërkesë të vetë subjekteve, në vitin 2012, u revokuan 5 licenca për zyra këmbimi valutor.

Numri në 2011	Licenca të reja	Revokime	Numri në 2012
301	26	5	322


Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>3</sup> Banka Kombëtare Tregtare ushtron veprimtarinë bankare edhe me degën në Kosovë.

<sup>4</sup> Të dhënat janë sipas Institutit të Statistikave deri në datë 1 tetor 2011.


<sup>5</sup> Viti 1999 shënoi fillimin e kryerjes së veprimtarisë së këmbimit valutor, nga subjekte që licencohen nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Ecuria e zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vite.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Shpërndarja gjeografike e zyrave të këmbimit valutor në vitin 2012.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Numri i zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vitin 2012.

Përsa i takon shpërndarjes gjeografike të zyrave të këmbimit valutor, ato janë të lokalizuara dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në 24 qytetet kryesore të vendit, dhe referuar shpërndarjes sipas rretheve konstatohet se përqendrimi më i madh i tyre mbetet në qytetin e Tiranës. Zgjerimi i shtrirjes gjeografike të subjekteve të licencuara për zyra këmbimi valutor gjatë vitit 2012 përfshiu 10 rrethe të vendit ku vetëm qyteti i Tiranës zë 58% të totalit të rritjes ose 15 zyra këmbimi valutor të licencuara rishtazi.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit të shumë zyrave të këmbimit valutor është edhe kryerja e veprimtarisë së agjentit për transferimin e parave për llogari të subjekteve financiare Ak-Invest sh.a. dhe Unioni Financiar i Tiranës sh.p.k. të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Në zbatim të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, edhe gjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë vazhdoi miratimin e kërkesave të subjekteve juridike për të vepruar si agjentëve të subjekteve financiare jobanka, që kryejnë veprimtarinë e transferimit të parave për llogari të tyre. Që prej vitit 2009, kur filloi procesi i miratimit të agjentëve, Banka e Shqipërisë ka miratuar deri në fund të vitit 2012, 291 agjentë të subjekteve Ak-Invest sh.a. dhe Unionit Financiar të Tiranës sh.p.k., dhe ka revokuar po gjatë kësaj periudhe 27 miratime të dhëna më parë. Revokimet janë bërë me kërkesë të subjektit financiar jobankë dhe të vetë agjentëve. Vetëm gjatë vitit 2012 me kërkesë të subjekteve financiare jobanka janë revokuar 13 agjentë. Në total, numri i agjentëve që kryejnë veprimtarinë e transferimit të parave për të dyja subjektet, në fund të vitit 2012 është 264 agjentë të miratuar.

Tabelë 2. Numri i agjentëve për transferimin e parave deri në fund të vitit 2012.

	Ak-Invest	Unioni Financiar i Tiranës
Agjentë që kryejnë vetëm veprimtarinë e transfertave të parave	24	94
Agjentë të transferimit të parave që janë edhe zyra këmbimi valutor	79	67
<b>Totali</b>	<b>103</b>	<b>161</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

As gjatë vitit 2012 nuk pati kërkesa për licencim të shoqërive të kursim-kreditit dhe as revokime të licencave të shoqërive të kursim-kreditit ekzistuese. Në fund të vitit 2012, numërohen 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit, 124 shoqëri të kursim-kreditit anëtare të unioneve të tyre dhe 2 shoqëri kursim-kreditit të pavarura.

Ndryshimet strukturore në pronësinë e bankave, gjatë vitit 2012, konsistojnë në ndryshime të pjesëmarrjeve joinfluencuese në zotërimin e aksioneve të kapitalit aksioner të bankave. Për këto ndryshime nuk kërkohet miratimi i Bankës së Shqipërisë, por sipas ligjit për bankat, subjektet janë të detyruara të njoftojnë Bankën e Shqipërisë. Konkretisht, Banka Tirana, Banka e Bashkuar e Shqipërisë dhe Banka Procredit njoftuan për ndryshime në strukturën e aksionerëve të tyre. Njoftime nga bankat u bënë gjatë kësaj periudhe edhe për rritjen e kapitalit aksioner të tyre. Banka Tirana sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka Societe Generale Albania sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a., Banka Credit Agricole sh.a., Banka Kombëtare Tregtare

sh.a. kanë realizuar rritje të kapitalit të tyre nëpërmjet injektimit nga aksionerët apo kapitalizimit të fitimeve të realizuara dhe të pushpërndara gjatë viteve të mëparshme. Gjithashtu subjektet financiare jobanka Raiffeisen Leasing sh.a., Fin-Al sh.p.k. dhe Fondi Besa sh.a. kanë rritur kapitalin e tyre.

Bashkëpunimi me autoritetet e huaja ka vijuar edhe gjatë vitit 2012. Zyra e Licencimit ka vazhduar komunikimin e saj me autoritetet e bankave të tjera qendrore për çështje të vlerësimit të reputacionit të administratorëve të huaj të propozuar të bankave. Kontakte të rregullta dhe shkëmbim informacioni reciprok janë mbajtur edhe me autoritetet brenda vendit.

#### TABELAT SHOQËRUESE PËR LICENCIMIN

Produkte elektronike	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Totali
Karta debiti	6	4	2	2				14
Karta krediti	5	3	1	1	1			11
Maestro card - debiti	1		1	1				3
Mastercard - krediti	-	-	1	2				3
VisaCard - debiti				1				1
VisaCard - krediti				1				1
MultiCash	1	-	-					1
ATM	6	4	2	2				14
POS	1	2	2	1				6
Internet banking	2	2	3	2	2			11
Phone banking	-	-	1					1
Mobile banking / SMS banking	-	-	1	1	1	1	1	5
Prepaid Card	-	-				1		1

Tabelë 3. Produktet elektronike bankare të miratuara nga Banka e Shqipërisë (2006 – 2012).

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Shpërndarja e produkteve / shërbimeve të e-banking sipas bankave në fund të vitit 2012.

BANKAT	ATM	POS	Internet Banking	Phone banking	Mobile / SMS banking	Karta elektronike (debit, kredit)
Banka Raiffeisen sh.a.	√	√	√		√	√
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	√	√	√		√	√
Banka Tirana Sh.a.	√		√	√	√	√
Banka NBG Albania	√					√
Banka Alpha Albania	√	√	√			√
Banka Procredit sh.a.	√	√	√			√
Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.	√		√			√
Banka Credins sh.a.	√	√	√			√
Banka Union sh.a.	√		√		√	√
Banka Societe Generale Albania sh.a.	√		√			√
Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.	√	√	√			√
Banka Veneto sh.a.	√		√			√
Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a.	√					√
Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.	√					√

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve.

Subjektet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Banka dhe degë të bankave të huaja	14	15	16	17	17	16	16	16	16	16	16
Subjekte financiare jobanka	5	7	7	7	6	6	7	13	17	19	21
Zyra të këmbimit valutor	58	58	54	58	60	112	189	221	284	301	322
Shoqëri të kursim-kreditit	113	131	130	131	125	130	133	135	126	126	126
Unione të shoqërive të kursim-kreditit	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Mbulimi me shërbime bankare deri në vitin 2012.

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Numri i bankave	16	17	17	16	16	16	16	16	16
Numri i punonjësve	2,816	3,479	4,189	5,155	6,493	6,404	6,384	6,714	6,836
Numri i degëve / agjencive brenda vendit	188	250	294	399	511	524	529	534	503
Numri mesatar i punonjësve për:									
- Bankë	176	205	246	322	406	400	399	420	427
- Njësi bankare	15	14	14	13	13	12	12	13	14
Numri i popullsisë (000)	3,135	3,149	3,152.6	3,170	3,193	3,195	n.a.	2,831.74	2,831.74*
Numri i popullsisë për:							n.a.		
- Bankë	195,938	185,235	185,447	198,125	199,563	199,688	n.a.	176,984	176,984
- Njësi bankare	16,676	12,596	10,723	7,945	6,249	6,097	n.a.	5,303	5,630
- Punonjës banke	1,113	905	753	615	492	499	n.a.	422	414

\*Për mungesë të dhënash, numri i popullsisë për vitin 2012 është mbajtur i pandryshuar.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Veprimtaritë që kryhen nga subjektet financiare jobanka.

Shërbimi i pagesave	Leasing	Kredidhënie	Mikrokredi	Faktoring	Të tjera
Unioni Financiar i Tiranës	Credins Leasing	Credins Leasing	Vision Fund Albania	Albanian Factoring Services (AFS)	Platinum Investment
Posta Shqiptare	Fin-Al	NOA (ish Opportunity Albania)	Capital Invest	Omnifactor	
Credins Leasing	Raiffeisen Leasing	Fondi Besa		Zig Factoring	
Ak-Invest	Tirana Leasing	Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF			
NOA	Landeslease	Tranzit			
EASYPAY	Sogelease	Ak-Invest			
M-PAY					

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2012.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë	Nr. i degëve e agjencive gjithsej
1	Banka Raiffeisen	39	64		103
2	Banka Kombëtare Tregtare	56	3	1	60
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	4	2		6
4	Banka Veneto	12			12
5	Banka Tirana	52	4		56
6	Banka NBG Albania	5	23		28
7	Banka Ndërkombëtare Tregtare	8			8
8	Banka Alpha Albania	43			43
9	Banka Intesa Sanpaolo Albania	17	14		31
10	Banka ProCredit	23	15		38
11	Banka Credit Agricole Shqipëri	13	9		22
12	Banka e Kreditit të Shqipërisë	1	2		3
13	Banka Credins	37	9		46
14	Banka Societe Generale Albania	45			45
15	Banka Union	15	14		29
16	Banka e Parë e Investimeve	5	4		9
	<b>Totali</b>	<b>375</b>	<b>163</b>	<b>1</b>	<b>539</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3 ANALIZA E ECURISË DHE RREZIQEVE NË SISTEMIN BANKAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA

#### 3.1 MJEDISI EKONOMIK

Ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje pozitive prej 1.6% në terma realë gjatë vitit 2012. Kjo ecuri është ndikuar nga pasqyrimi më i plotë i stimulit monetar dhe nga përmirësimi i mjedisit të jashtëm ekonomik e financiar. Aktiviteti ekonomik mbetet në nivelin potencial pavarësisht rritjes së prodhimit. Ky i fundit nuk është shoqëruar me një ulje të pasigurive të përgjithshme, duke ndikuar konsumin dhe investimet private, e për rrjedhojë edhe kërkesën e ofertën për kredi. Rrjedhimisht, kërkesa për kredi vlerësohet të jetë e dobët dhe e kushtëzuar nga ecuria e aktivitetit ekonomik me ritme më të ngadalta, nga pasiguria që vërehet në projeksionet për të ardhmen, si dhe nga sjellja e kujdesshme e sistemit bankar në drejtim të kredidhënies.

Norma mesatare vjetore e inflacionit ishte në nivelin prej 2%. Presionet inflacioniste kanë qenë të ulëta duke bërë që inflacioni të jetë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2012, duke reflektuar edhe politikën e kujdesshme monetare.

Banka e Shqipërisë gjatë këtij viti e ka ndryshuar tre herë normën bazë të interesit duke e çuar atë në 4%. Uljet e njëpasnjëshme të normës bazë të interesit ndihmojnë në uljen e mëtejshme të normave afatshkurtra të interesit në tregjet financiare, duke nxitur aktivitetin dhe duke ulur primet e tregtimit të likuiditetit në to. Nëpërmjet reduktimit të kostove të financimit të sistemit bankar, autoriteti monetar synon uljen e interesave të kredive dhe rritjen e konsumit dhe të investimeve në ekonomi.

Sistemi bankar regjistron bilance të shëndosha dhe likuide dhe pozita të mira kapitalizuese, por vijon të karakterizohet nga një kujdes i rritur në financimin e investimeve. Vëllimi i aktivitetit u zgjerua me ritme më të ulëta, në kushtet e rritjes më të ngadaltë të depozitave dhe uljes së ndjeshme të ritmeve të kreditimit. Për sektorin bankar, rreziku i kreditit përfaqëson sfidën më të rëndësishme të veprimtarisë, ndërsa ekspozimi i sistemit ndaj rreziqeve të tregut dhe të likuiditetit mbetet i moderuar.

### 3.2 ZHVILLIMET KRYESORE NË ECURINË E SISTEMIT BANKAR

Zhvillimet bankare gjatë vitit 2012 patën si veçori dalluese rritjen me ritme më të ulëta të portofolit të kredisë në krahasim me vitet e fundit. Kjo rritje e ulët pati ndikimin e saj strukturor edhe në rritjen e treguesit të kredive me probleme, ndërkohë që edhe vetë kreditë me probleme pësuan rritje të mëtejshme gjatë këtij viti. Rritja modeste e portofolit të kredive është kompensuar nga ana tjetër me rritjen e veprimtarisë bankare në instrumente të letrave me vlerë.

Megjithatë, rreziku i kredisë i pranishëm në veprimtarinë bankare është shoqëruar me një nivel të kënaqshëm të kapitalizimit të bankave. Ky nivel kapitalizimi shfaqet më i lartë se ai i një viti më parë dhe njëkohësisht gjen burime më të mira rritjeje në tregun vendas në kushtet kur rezultati financiar i bankave në fund të vitit 2012 është ndjeshëm më i lartë se në vitin 2011.

Po kështu niveli i likuiditetit të bankave është shfaqur i qëndrueshëm dhe i kënaqshëm përgjatë gjithë vitit 2012, si në monedhën vendase ashtu edhe atë të huaj. Ky nivel likuiditeti është ruajtur shoqëruar me rritjen e vazhdueshme të depozitave nga publiku.

Një përmbledhje e zhvillimeve kryesore të konstatuara në veprimtarinë bankare gjatë vitit 2012 pasqyrohet si më poshtë:

1. Totali i tepricës së kredisë të sistemit bankar përllogaritet i rritur prej rreth 2%, nivel ky më i ulët se ai i një viti më parë (2011: 15.3%);
2. Treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë në terma bruto u rrit më tej, duke regjistruar vlerën prej 22.5% në dhjetor 2012, nga 18.8% në vitin 2011;
3. Niveli i mbulimit me provigjione vijon të mbetet i kënaqshëm, duke shfaqur ritëm rritjeje më të lartë se kreditë me probleme. Në fund të vitit 2012, evidentohet një nivel prej 55.4% nga 51.8% që shënonte një vit më parë;
4. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është mbi nivelin minimal rregullator prej 12%, me një rritje të kënaqshme krahasuar me një vit më parë, duke arritur nivelin prej 16.2% nga 15.6% që rezultonte në fund të vitit 2011;
5. Rezultati financiar i sistemit bankar shfaqet në nivele të kënaqshme në fund të vitit 2012 me rreth 3.8 miliardë lekë, disa herë më i lartë se ai i vitit 2011 (0.7 miliardë lekë).
6. Treguesit e përfitueshmërisë RoAA dhe RoAE përllogariten në vlera pozitive prej 0.33% dhe 3.78%; krahasuar me vitin e kaluar shfaqin një përmirësim të dukshëm.

### 3.3 STRUKTURA E KAPITALIT SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS


Gjatë vitit 2012, kapitali i paguar në sistemin bankar ka shënuar një rritje prej 10 miliardë lekësh ose 11.5% kundrejt një viti më parë. Kapitali i huaj edhe këtë vit ka dhënë kontributin dominues, duke përfaqësuar 86.3% të rritjes



së sistemit. Ky kapital është rritur me 8.6 miliardë lekë ose 10.7%, ndërkohë që kapitali me origjinë shqiptare është rritur me 1.4 miliardë lekë ose 22% kundrejt vitit 2011.

Pesha e kapitalit të huaj në sistemin bankar shqiptar paraqitet në 92.2% në fund të vitit 2012, duke prezantuar një rënie jomateriale krahasuar me një vit më parë. Kapitali me origjinë nga Bashkimi Evropian vijon të zërë peshën më të madhe në strukturën e kapitalit të sistemit bankar, edhe pse pesha e tij ka rënë me gati 6 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke u prezantuar në 76% në fund të vitit 2012.

Grafik 6. Struktura e pronësisë së kapitalit të sistemit bankar, në fund të vitit 2012.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3.4 AKTIVEVET DHE PASIVET

#### 3.4.1 STRUKTURA E AKTIVEVE DHE PASIVEVE

Gjatë vitit 2012, aktivet e sistemit bankar shënuan një rritje prej rreth 67.7 miliardë lekësh ose 6%, çka dëshmon një ritëm të kënaqshëm rritjeje. Megjithatë krahasuar me një vit më parë, gjatë të cilit aktivet u rritën me 129.5 miliardë lekë ose me 13.1%, rritja e aktiveve të sistemit bankar është përgjysmuar. Edhe portofoli i kredive ka shfaqur një rritje pozitive, konkretisht me 11.6 miliardë lekë ose me 2%.

Shkalla e ndërmjetësismit të sistemit bankar në ekonomi dhe kontributi i aktivitetit të kredidhënies ka vijuar të rritet në linjë me prirjen e shfaqur ndër vite, shprehur nëpërmjet rritjes së peshës së totalit të aktiveve dhe kredive ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Në fund të vitit 2012, këto pesha paraqiten përkatësisht në nivelet 87.9% dhe 42.7%, kundrejt 86.1% dhe 40% të një viti më parë.

Tabelë 9. Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.

Treguesit	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Totali i aktiveve (në mld lekë)	339.3	373.6	426.4	496.6	624.3	742.9	834.1	886.3	990.6	1,120.2	1,187.9
Totali i aktiveve/PBB (në %)	54.5	53.8	56.8	60.9	70.8	76.8	76.7	77.5	81.0	86.1	87.9
Totali i kredive/PBB (në %)	6.3	7.3	9.3	15.7	22.4	30.2	36.5	39.3	40.1	40.0	42.7

\* Raporti ndaj PBB-së mbështetet në vlerësimin paraprak për PBB-në e vitit 2012.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e aktiveve të sistemit bankar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shfaq këto zhvillime kryesore:

- rritje të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare me 49 miliardë lekë ose 14.7%, e cila buron kryesisht nga rritja e ndjeshme e marrëdhënieve me bankat e tjera, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare me 46.1 miliardë lekë ose 39.2%, dhe

rritja e marrëdhënieve me Bankën Qendrore me 11 miliardë lekë ose 12.2%; bonot e thesarit kanë pësuar një rënie prej 8.4 miliardë lekësh ose 8%;

- rritje të kredidhënies me 11.6 miliardë lekë ose me 2%;
- rritje të veprimeve me letrat me vlerë (pa përfshirë bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare) me 12.5 miliardë lekë ose 5.1%, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së investimit në letra me vlerë me të ardhura fikse me 17.9 miliardë lekë ose 7.6%.

Tabelë 10. Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar.

Treguesit:	Dhjetor`10			Dhjetor`11			Dhjetor`12		
	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi***	Shuma	Pesha	Ndryshimi	Shuma	Pesha	Ndryshimi
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	296.2	29.9	16.5	333.2	29.7	12.5	382.2	32.2	14.7
Nga të cilat:									
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	82.2	8.3	19.2	91.2	8.1	11.0	102.2	8.6	12.1
- Bono thesari	103.0	10.4	(3.1)	104.6	9.3	1.6	96.2	8.1	(8.0)
- Marrëdhënie me bankat e tjera	91.9	9.3	58.5	117.6	10.5	28.0	163.7	13.8	39.2
2. Veprime me klientët (bruto)	486.5	49.1	9.1	561.7	50.1	15.5	573.5	48.3	2.1
3. Veprime me letrat me vlerë	210.7	21.3	18.5	244.2	21.8	15.9	256.7	21.6	5.1
4. Mjete të tjera	9.1	0.9	11.7	13.8	1.2	51.6	21.4	1.8	55.1
5. Mjete të qëndrueshme	13.8	1.4	(5.8)	13.9	1.2	0.5	15.9	1.3	14.4
Totali i aktiveve	990.6	100.0	11.8	1,120.2	100.0	13.1	1,188.0	100.0	6.1

\*në miliardë lekë, \*\*në përqindje, \*\*\*në përqindje

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e pasiveve të sistemit bankar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shfaq këto zhvillime kryesore:

- rënie e veprimeve me thesarin dhe ndërbankare me 7.9 miliardë lekë ose 10.9% kryesisht si rrjedhojë e rënies me 3.6 miliardë lekë ose 14.4% të zërit 'bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme' dhe rënies së huave me 3.7 miliardë lekë ose 15.4%;
- rritje me 66.9 miliardë lekë ose 7.3% e veprimeve me klientët, e përcaktuar nga rritja e veprimeve me sektorin privat me 65.9 miliardë lekë ose 7.3%;
- rritje e burimeve të përhershme me 6.6 miliardë lekë ose 5.9%.

Tabelë 11. Ecuria e zërave kryesorë të pasiveve të sistemit bankar.

Treguesit:	Dhjetor`10			Dhjetor`11			Dhjetor`12		
	Shuma	Pesha	Ndryshimi	Shuma	Pesha	Ndryshimi	Shuma	Pesha	Ndryshimi
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	61.2	6.2	(31.9)	72.1	6.4	17.9	64.2	5.4	(10.9)
2. Veprime me klientët (bruto)	805.0	81.3	17.7	911.2	81.3	13.2	978.1	82.3	7.3
3. Detyrime të tjera	7.5	0.8	32.9	10.2	0.9	35.5	11.3	1.0	10.9
4. Burime të përhershme	104.8	10.6	9.1	113.4	10.1	8.2	120.1	10.1	5.9
Totali i pasivit	990.6	100.0	11.8	1,120.2	100.0	13.1	1,188.0	100.0	6.1

\*në miliardë lekë, \*\*në %, \*\*\*në %

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2012, pesha e zërave jashtë bilancit ndaj aktiveve totale të sistemit u rrit në nivelin 107.9% nga 103% në fundin e vitit 2011. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes më të shpejtë të zërave jashtë bilancit, me 10.8% kundrejt rritjes prej 6.1% të aktiveve totale. Siç ilustron tabelën 12, gjatë këtij viti, zërat kryesorë jashtë bilancit kanë shënuar rritje, me përjashtim të angazhimeve të marra financiare të cilat kanë pësuar rënie. Në strukturën e zërave jashtë bilancit, angazhimet e marra janë elementi më i rëndësishëm me një peshë prej 88.6%, ndërkohë që angazhimet e dhëna dhe transaksionet në valutë zënë përkatësisht 8.2% dhe 2.4% ndaj totalit të zërave jashtë bilancit. Angazhimet e marra në formën e garancive në favor të klientëve vijojnë të zënë peshën kryesore në zërat jashtë bilancit, me rreth 83.7%.

Treguesit:	Dhjetor`11		Dhjetor`12	
	Në mld lekë	Në %	Në mld lekë	Në %
TOTALI	264.8	29.8	124.6	(52.9)
Angazhime të dhëna	12.1	19.0	29.1	140.6
Nga të cilat:				
- Angazhime financimi	(1.5)	(5.2)	4.8	(421.6)
- Garanci	10.3	41.8	3.7	(63.8)
- Angazhime për letrat me vlerë	9.3	253.8	19.7	111.4
Angazhime të marra	244.7	30.7	91.4	(62.6)
Nga të cilat:				
- Angazhime financimi	13.2	64.0	(5.0)	(137.8)
- Garanci	228.2	29.8	75.8	(66.8)
Transaksione në valutë	6.7	23.8	(4.0)	(160.0)
Angazhime të tjera	0.2	101.3	0.3	31.3
Angazhime për instrumente financiare	1.1	1,313.3	7.8	613.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 12. Ndryshimi i zërave jashtë bilancit gjatë vitit 2012.

### 3.4.2 PËRQENDRIMI

Sistemi bankar ka vijuar edhe gjatë vitit 2012 me shfaqjen e prirjeve të qëndrueshme në drejtim të shpërndarjes së burimeve financiare dhe përdorimit të tyre. Kjo është pasqyruar edhe në vlerat e indeksit Herfindahl<sup>6</sup>, i cili mat shkallën e përqendrimit në sistem. Treguesit e përqendrimit, të shprehur nëpërmjet këtij indeksi, të përlogaritur për totalin e aktiveve, depozitave dhe kredive, edhe gjatë vitit 2012 mbeten në nivele afër zeros duke dëshmuar për një përqendrim të ulët në sistemin bankar në drejtim të aktiveve, depozitave dhe kredive, pra për një shpërndarje më të mirë të peshave në treg dhe rrjedhimisht të një konkurrueshmërie të kënaqshme.

Tabelë 13. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.

Treguesit	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Indeksi H (aktivet)	0.27	0.21	0.18	0.15	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15
Indeksi H (depozita)	0.31	0.24	0.20	0.17	0.17	0.15	0.16	0.16	0.15
Indeksi H (kredia)	0.11	0.10	0.11	0.12	0.11	0.11	0.11	0.12	0.12

Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>6</sup> Indeksi i Herfindhalit, i njohur ndryshe si indeksi Herfindhal-Hirschman (HHI), është një indikator i konkurrueshmërisë në tregje. Vlerat e tij luhaten në segmentin 0-1. Një rritje në vlerat e këtij treguesi (vlera sa më pranë numrit 1) dëshmon për një rënie në konkurrueshmëri dhe anasjelltas.

## 3.5 ADMINISTRIMI I RREZIQEVE NË VEPRIMTARINË BANKARE

## 3.5.1 RREZIKU I KREDISË

## Aktiviteti kreditues


Totali i kredisë evidenton një rritje me 11.6 miliardë lekë ose me rreth 2% gjatë vitit 2012. Rritja më e lartë e tepicës së kredisë konstatohet në tremujorin e parë të vitit 2012 me 5.6 miliardë lekë, ndjekur nga tremujori i tretë me 5.3 miliardë lekë.

Tabelë 14. Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2012.

Rritja tremujore e kredisë	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV
Në milionë lekë	5,628.22	66.49	5,257.82	646.29
Në përqindje	0.99	0.01	0.92	0.11

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7. Ecuria e rritjes mujore të kredisë gjatë vitit 2012 (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja mujore e kredisë karakterizohet nga ecuria e luhatshme nga një muaj në tjetrin. Rritja mesatare mujore e kredisë gjatë vitit 2012 është në vlerën 0.2%. Rritja mujore më e lartë e kredisë evidentohet në shtator 2012 prej 1.06%, ndjekur nga muaji mars 2012 me rreth 0.8%. Në të kundërt, muaji që ka pasur rënien më të madhe të kredisë rezulton muaji prill 2012 me një rënie prej 0.5%.

Në një analizë të totalit të kredisë sipas llojit të subjektit (grafik 8) vërehet se sektori privat vazhdon të ketë peshën më të madhe në totalin e kredisë dhe zë rreth 69.7% në fund të vitit 2012, nga 70.1% që rezultonte në vitin 2011. Përsa i përket kredisë akorduar individëve, në dhjetor 2012, ajo zë 25.9% të portofolit ose 0.4 pikë përqindje më pak krahasuar me vitin 2011. Gjatë periudhës

dhjetor 2011 – dhjetor 2012, kredia dhënë sektorit privat dhe individëve ka regjistruar një rritje me përkatësisht 1.5% dhe 0.4%.


Përbërja e portofolit të kredisë sipas monedhës dhe subjektit<sup>7</sup> evidenton se rreth 64.4% e kredive dhënë biznesit është kredi në monedhë të huaj, me një rënie prej 5.3 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2011. Kredia në monedhën EUR zë rreth 86.6%, ndërsa ajo në USD zë rreth 13.3% të portofolit në monedhë të huaj. Pësja e kredisë në monedhë të huaj për individë, ndaj totalit të kredive për individë evidentohet në nivelin 55.3% nga 56.6% në vitin 2011. Kredia në monedhën EUR zë 97.6% në totalin e kredisë në monedhë të huaj dhe ajo në USD vetëm 2.4%.

<sup>7</sup> Të dhënat nuk përfshijnë jorezidentët.

Rritja më e madhe e kredisë ndaj tepricës së kredisë gjatë vitit 2012 në sektorin publik është realizuar gjatë tremujorit të katërt me 2.7 miliardë lekë ose 13.6%, ndjekur nga tremujori i dytë me rreth 1.4 miliardë lekë ose 7.1%. Në vlerë absolute, në fund të vitit 2012, portofoli i kredisë për këtë sektor raportohet në nivelin 25.3 miliardë lekë nga 20.2 miliardë lekë që ishte në fund të vitit 2011, duke zënë kështu një peshë prej 4.4% ndaj portofolit të kredisë nga 3.6% në dhjetor 2011.

Analiza sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit të kredisë evidenton peshën më të madhe të kredisë “overdraft” për bizneset, pasuar nga kredia për “investime për pasuri të paluajtshme”, sërish dhënë biznesit, dhe nga kredia për “investime për pasuri të paluajtshme” për individë. Ndërsa, rritjen më të lartë gjatë vitit 2012, e shfaq kredia “overdraft” dhënë individëve, e pasuar nga kredia për “investime për pasuri të paluajtshme” dhënë biznesit dhe kredia për “kapital qarkullues” dhënë biznesit.

Grafik 8. Teprica e kredisë akorduar biznesit dhe individëve ndaj tepricës totale të kredisë (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 15. Kredia sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit (në mld lekë).

PËRSHKRIMI	Dhjetor 2011	Pesha në %	Dhjetor 2012	Pesha në %	Ndryshimi në % dhjetor 2012-dhjetor 2011
Kredia gjithsej	534.1	100.0	544.0	100.0	1.8
Kredia dhënë biznesit	392.5	73.5	401.7	73.8	2.3
Overdraft	123.6	23.1	119.9	22.4	(3.0)
Kapital qarkullues	71.0	13.3	78.5	14.7	10.6
Investime në blerje pajisjesh	100.6	18.8	88.8	16.6	(11.7)
Investime për pasuri të paluajtshme	97.3	18.2	114.4	21.4	17.5
Kredia dhënë individëve	141.6	26.5	142.3	26.6	0.5
Overdraft	7.2	1.3	8.6	1.6	20.3
Konsum i mallrave jo të qëndrueshme	17.9	3.3	17.3	3.2	(3.0)
Konsum i mallrave të qëndrueshme	9.2	1.7	8.7	1.6	(5.2)
Për pasuri të paluajtshme	99.9	18.7	100.9	18.9	1.0
Për ushtrim aktiviteti	7.6	1.4	6.8	1.3	(10.4)

Shënim: Të dhënat e tabelës së mësipërme i referohen vetëm klientëve rezidentë dhe në to nuk përfshihen interesat e përlogaritura.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e kredisë sipas afatit vazhdon të ruajë pothuajse të njëjtën strukturë me atë të vitit 2011, me një zhvendosje të lehtë nga kredia afatshkurtër dhe afatmesme drejt kredisë afatgjatë. Në fund të vitit 2012, kredia afatgjatë vijon të ketë peshën kryesore në totalin e portofolit të kredisë, e ndjekur nga kredia afatshkurtër dhe në fund kredia afatmesme.

Tabelë 16. Struktura e tepricës së kredisë sipas afatit, në përqindje.

Afati i maturimit	Dhjetor 2007	Dhjetor 2008	Dhjetor 2009	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Afatshkurtër	31.3	33.4	33.4	32.4	33.6	33.5	33.5	33.4	33.2
Afatmesme	25.1	20	19.8	20.7	20.8	20.6	20.6	20.2	20.0
Afatgjatë	43.6	46.6	46.8	46.9	45.6	45.8	45.9	46.4	46.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Portofoli i kredive sipas monedhës gjatë vitit 2012 evidenton një rritje të kredisë në monedhën vendase, ku rritja më e lartë e saj evidentohet në tremujorin e katërt, tremujor në të cilin shënohet njëkohësisht dhe rënia më e lartë e kredisë në valutë, me rreth 6%.

Tabelë 17. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhës (në përqindje).

Monedha	Dhjetor 2007	Dhjetor 2008	Dhjetor 2009	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Lekë	27.5	27.4	29.8	30.2	32.1	31.8	32.9	33.5	35.5
Valutë	72.5	72.6	70.2	69.8	67.9	68.2	67.1	66.5	64.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kredinë sipas monedhës, struktura e portofolit të kredisë gjatë vitit 2012 dominohet sërish nga kredia në valutë, por me një rënie të peshës së saj krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, çka tregon një zhvendosje të lehtë të kredisë së dhënë, nga kredia në valutë në kredi dhënë në monedhën vendase.



Gjatë dy tremujorëve të parë të vitit 2012, kredia në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit<sup>8</sup> ka shënuar një rënie, përkatësisht me 8.2 pikë përqindje dhe 0.2 pikë përqindje. Nga ana tjetër, gjatë tremujorit të tretë dhe atij të katërt, ky tregues ka pësuar një rritje përkatësisht me 0.2 dhe 0.8 pikë përqindje, duke zënë kështu, një peshë prej 48.5% në fund të vitit 2012. Në baza vjetore, kredia në valutë e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit evidenton një rënie prej 7.4 pikë përqindjeje.

<sup>8</sup> Përcaktimi për kreditë e pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit jepet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, nr. 62, datë 14.09.2011 "Për administrimin e rrezikut të kredisë", neni 4, pika 2, shkronja "c".

Tabelë 18. Pjesa e pambuluar e kredisë në valutë nga rreziku i kursit të këmbimit (në përqindje).

	T4`08	T4`09	T4`10	T4`11	T1`12	T2`12	T3`12	T4`12
Kredia në valutë e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit	52.4	55.2	51.0	55.9	47.8	47.5	47.7	48.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2012, struktura e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë (referuar vetëm klientëve rezidentë) vijon të mbetet pothuaj pa ndryshime të dallueshme krahasuar me një vit më parë. Sektorët më të kredituar të ekonomisë janë "Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë", pasuar nga sektori i "Ndërtimit", megjithëse me një rënie prej rreth 10.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, dhe nga sektori i "Industriës përpunuese". Ndërsa, në terma absolutë, sektorët e ekonomisë që kanë pësuar rritjen më të lartë vjetore janë "Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit", "Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë" dhe "Pasuritë e paluajtshme, dhënia me qira etj."

Një kombinim i cilësisë së portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë me peshën e secilit sektor në nivel sistemi, evidenton se nivelin më të lartë të kredive me probleme e ka sektori "Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë", pasuar nga "Industria përpunuese" dhe nga "Ndërtimi".

Tabelë 19. Kredia sipas degëve të ekonomisë (në %).

Përshkrimi	Dhjetor '11	Dhjetor '12	Ndryshimi në %	Kredi me probleme /Teprica e kredisë Dhjetor '11	Kredi me probleme /Teprica e kredisë Dhjetor '12	Ndryshimi në %
Bizneset	73.5	73.8	3.2	20.8	25.3	24.2
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.0	1.0	1.2	13.6	23.1	72.1
Peshkimi	0.2	0.2	-12.6	6.9	6.8	-13.9
Industria nxjerrëse	1.2	1.4	15.1	12.9	13.8	23.8
Industria përpunuese	10.8	10.6	0.1	21.3	27.2	28.0
Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	6.9	8.6	25.5	10.7	11.3	33.6
Ndërtimi	13.3	11.7	-10.5	29.6	32.2	-2.8
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe i artikujve shtëpiakë	24.5	25.4	6.9	21.3	29.2	44.5
Hotelet dhe restorantet	3.0	3.2	10.0	45.3	44.5	8.1
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	2.3	2.1	3.7	15.2	22.1	33.6
Ndërmjetësim monetar dhe financiar	2.1	2.4	14.8	1.0	0.2	-75.6
Pasuritë e patundshme, dhënia me qira etj.	0.5	1.1	118.2	35.5	32.5	100.2
Administrimi publik	0.3	0.1	-51.3	20.5	5.0	-88.2
Arsimi	0.8	1.0	22.7	3.9	12.0	276.2
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	0.9	0.9	5.2	27.0	42.1	63.9
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	3.1	2.8	-9.6	8.7	10.2	5.9
Të tjera	2.4	1.4	-41.2	11.8	10.3	-48.8
<b>Individët</b>	<b>26.5</b>	<b>26.2</b>	<b>0.5</b>	<b>15.7</b>	<b>17.7</b>	<b>13.4</b>
<b>Totali</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>2.4</b>	<b>19.5</b>	<b>23.3</b>	<b>21.9</b>

Shënim: Të dhënat e tabelës së mësipërme i referohen vetëm klientëve rezidentë dhe në to nuk përfshihen interesat e përlogaritura.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

## Cilësia e aktiveve

Gjatë vitit 2012, kredia me probleme është rritur me rreth 23.7 miliardë lekë. Ritmi i rritjes së kredisë me probleme ka qenë më i lartë se ritmi i rritjes së tepricës së kredisë së sistemit bankar, e si rrjedhojë evidentohet rritje e treguesit të cilësisë së portofolit të kredisë “kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë të sistemit bankar” me rreth 3.7 pikë përqindje, duke arritur në rreth 22.5%.


Në fund të vitit 2012, treguesi “Kredi me probleme/Tepricës së kredisë (neto<sup>9</sup>)”, rezulton në rreth 11.56% nga niveli 10% i një viti më parë.

Grafik 10. Rritja e portofolit të kredive me probleme dhe e portofolit të kredive (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Ecuria e tepricës së kredisë me probleme në sistemin bankar.



■ Teprica e kredisë me probleme (në mln lekë, në të majtë)  
—Kredi me probleme/Tepricë kredie (në të djathtë)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e strukturës së portofolit të kredisë sipas klasave të cilësisë, evidenton rënie të peshës së kredive cilësore kundrejt rritjes së peshës të kredive me probleme, në fund të vitit 2012. Në portofolin e kredive cilësore, evidentohet rënie e kredive të klasifikuara “standarde” dhe rritje e peshës së kredive të klasifikuara “në ndjekje” krahasuar me fundin e vitit 2011. Ndërkohë, në portofolin e kredive me probleme, evidentohet rritje e peshës për të tre klasat, por rritje më e madhe evidentohet në peshën e kredive të klasifikuara “të dyshimta” dhe “të humbura”.

Tabelë 20. Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.

Klasifikimi i kredisë	2010				2011				2012			
	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV
Standard	80.8	81.2	78.7	79.0	73.8	73.1	73.2	73.8	72.0	71.2	69.4	69.2
Në ndjekje	7.6	6.6	7.5	7.0	11.5	9.9	8.5	7.4	7.9	7.7	7.9	8.3
Nënstandard	5.4	5.4	5.9	6.2	5.9	8.0	8.9	9.3	10.1	9.6	10.3	9.7
Të dyshimta	3.0	3.2	3.9	3.7	4.2	4.0	4.2	3.9	4.1	4.9	5.4	5.2
Të humbura	3.3	3.7	4.0	4.1	4.6	5.0	5.2	5.6	6.0	6.6	7.1	7.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>9</sup> Ky tregues është llogaritur duke marrë në konsideratë tepricën e kredisë dhe kreditë me probleme duke zbritur fondet rezervë që krijojnë bankat për mbulimin e humbjeve nga kreditë.




Në fund të vitit 2012, fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë rezultojnë në rreth 72 miliardë lekë me një rritje prej rreth 17 miliardë lekësh nga fundi i vitit 2011. Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë gjatë vitit 2012 kanë shfaqur pothuaj të njëjtin ritëm rritjeje me kreditë me probleme gjatë tremujorit të parë dhe të tretë, ndërsa gjatë tremujorit të dytë dhe atij të katërt, ritmi i rritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë rezulton të jetë më i lartë se ritmi i rritjes së kredisë me probleme. Si rezultat, në fund të vitit 2012, treguesi “Fonde rezervë për kreditë me probleme/Kredi me probleme”, i cili mat shkallën e mbulimit me provigjone, rezulton në rreth 55.4%, duke u rritur me 3.6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2011 (51.8%).

Përsa i përket cilësisë së kredisë të ndarë sipas llojit të subjektit, evidentohet se, në harkun kohor të një viti, kredia me probleme për biznesin ka shfaqur ritme rritjeje më të larta se kredia për individët. Në fund të vitit 2012, treguesi i kredive me probleme për biznesin rezulton në nivelin 25.9% ndërsa për individë ky tregues është 17.2%.


Përsa i përket ndarjes së kredive me probleme sipas valutave rezulton se portofoli i kredive me probleme në valutë paraqet një tregues më të lartë të kredive me probleme në nivelin 24.7% krahasuar me portofolin në lekë me 18.5%.

Grafik 12. Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë me probleme.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Teprica e kredisë me probleme për bizneset dhe individët.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Teprica e kredisë me probleme sipas monedhave.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Ecuria 3-mujore e raportit “kredi me probleme në valutë /teprica e kredisë në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit” për vitin 2012.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. 10, 20, 50 dhe 100 kredimarrësit më të mëdhenj të sistemit në përqindje ndaj tepricës së kredisë së sistemit (31 dhjetor 2012).




Brenda portofolit të kredisë në valutë të klasifikuar si e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, kredia me probleme në valutë zë 50.8%. Gjatë periudhës njëvjeçare, dhjetor '11 – dhjetor '12, shënohet një rritje e treguesit të kredisë me probleme në valutë të pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit me 15.6 pikë përqindje. Arsyeja kryesore e kësaj rritjeje është rënia e kredisë së klasifikuar si e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit me 15.8% dhe rritja e kredisë me probleme në valutë me rreth 21.7%.

Referuar fundit të vitit 2012, analiza e kredimarrësve më të mëdhenj të sistemit, evidenton një rritje të peshës së secilit prej grupeve të 10, 20, 50 dhe 100 kredimarrësve më të mëdhenj ndaj totalit të kredive të sistemit.

Rreth 88.3% e vëllimit të kredisë dhënë 10 kredimarrësve më të mëdhenj është e klasifikuar si kredi rregull (standarde dhe në ndjekje) dhe 11.7% e saj është e klasifikuar në klasat “nënstandarde” dhe “të dyshimta” (përkatesisht 6.16% dhe 2.02%). Krahasuar me fundin e vitit 2011, evidentohet një rënie e portofolit të kredisë së rregullt për 10 kredimarrësit më të mëdhenj me rreth 3.5 pikë përqindje. Megjithatë, cilësia e kredisë për 10 kredimarrësit më të mëdhenj vazhdon të jetë më e mirë se e totalit të portofolit.

Grafik 17. Shpërndarja e vëllimit të kredisë së 10 kredimarrësve më të mëdhenj sipas klasifikimit.




Në dhjetor 2012, pjesa më e madhe e portofolit të kredive (78%) rezulton e kolateralizuar dhe më e lartë se në dhjetor 2011 (76%). Analiza e

portofolit të kredive, bazuar në llojin e kolateralit, evidenton faktin se pjesa më e madhe e kredive të sistemit (55%), është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme, ku rreth 37% e saj është e tipit rezidencial.

Portofoli i kredive në valutë paraqitet i mirëkolateralizuar sa dhe ai në monedhën vendase, 78% në valutë dhe 77% në monedhën vendase. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, evidentohet një rënie e kredisë së kolateralizuar në valutë me 1 pikë përqindje, ndërkohë që për monedhën vendase ky tregues paraqitet i përmirësuar me 6 pikë përqindje.

Grafik18. Niveli i mbulimit të kredive me kolateral sipas llojeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Llojet e kolateralit	Individë		Biznese		Totali	
	Lekë	Valutë	Lekë	Valutë	Lekë	Valutë
Pasuri të paluajtshme	57%	80%	48%	50%	50%	57%
Cash	4%	6%	2%	2%	2%	3%
Kolateral tjetër	8%	7%	31%	22%	24%	18%
Kredi e pakolateralizuar	31%	7%	19%	26%	23%	22%
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 21. Llojet e kolateraleve të shpërndara sipas sektorëve dhe monedhave (në përqindje).

Megjithë zhvillimet e sipërmendura, ku paraqitet një nivel i lartë i treguesit të kredive me probleme, analizat *stress-test* të zhvilluara nga Banka e Shqipërisë tregojnë se sistemi bankar zotëron një nivel të mirë kapitali, i cili është në gjendje të përballojë një nivel të konsiderueshëm humbesh si pasojë e rreziqeve që shfaqen nga veprimtaria kredituese dhe veprimtaritë e tjera.

### 3.5.2 RREZIKU OPERACIONAL DHE I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Fokusi i Njësisë së Mbikëqyrjes së Rrezikut Operacional, në kushtet e ekzistencës tashmë të një baze rregullatore të dedikuar (në fuqi që nga viti 2011), ka qenë monitorimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin prej saj, si dhe angazhimi në hartimin e projektregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të raportuara në Bankën e Shqipërisë lidhur me rrezikun operacional ka mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të analizave nga jashtë me qëllim identifikimin proaktiv të dobësive potenciale të bankave. Mbikëqyrja aktive nga jashtë është konkretizuar me evidentimin e ekspozimeve sipas linjave të biznesit, duke i shërbyer më mirë hartimit të profilit të çdo banke, krijimit të një baze të dhënash për humbjet operationale, identifikimit të problematikës etj. Monitorimi periodik i treguesve të rrezikut

operacional ka krijuar mundësi reale për të bërë vlerësime të frekuencave, si dhe për të analizuar tendencat e bankave.

Korniza rregullatore është dizenuar me objektiv nxitjen e kulturës së evidentimit dhe vetëvlerësimit paraprak të rrezikut operacional nga vetë bankat, nëpërmjet kërkesave për alokimin e burimeve njerëzore në struktura të specializuara, si dhe hartimit të një sistemi të brendshëm që siguron identifikimin dhe kontrollin në vazhdimësi të rrezikut operacional. Nën këtë këndvështrim, ekzaminimet në vend kanë konfirmuar një reagim të mirë të sistemit në drejtim të përputhshmërisë me standardet e administrimit të rrezikut operacional si në termat e strukturave të brendshme të krijuara / përshtatura për këtë qëllim, ashtu edhe në ato të zhvillimit të politikave e procedurave për evidentimin dhe menaxhimin e tij. Vlerësohet pozitivisht zhvillimi i infrastrukturës rregullative të brendshme dhe përpjekja për konsolidimin, në të gjitha strukturat e bankës e kulturës për administrimin e kësaj kategorie rreziku.

Objektivi i Bankës së Shqipërisë për zbatimin afatshkurtër të rregullores së re për mjaftueshmërinë e kapitalit, ku parashikohet edhe kërkesa specifike për kapital për rrezikun operacional, ka kontribuar në nxitjen e interesit të drejtuesve të bankave për zhvillimin e praktikave të administrimit të këtij rreziku.

Për sa i përket mbikëqyrjes së rrezikut të teknologjisë së informacionit në banka, në përputhje me rregulloren “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”, rastet e evidentuara i referohen plotësisht dhe përmirësimit të kuadrit të brendshëm rregullativ të bankës, kryesisht në lidhje me: përmirësimin e programeve të tyre të sigurisë, monitorimet dhe raportimet e incidenteve të sigurisë, përmirësimin e vlerësimit të rrezikut të TIK-së, duke përfshirë klasifikimin e sistemeve e aplikimeve të përdorura dhe identifikimin e dobësive dhe kërcënimeve të mundshme, përmirësimit të planeve të vazhdimësisë së biznesit bazuar në madhësinë dhe kompleksitetin e subjektit, etj.

Për sa i përket subjekteve financiare jobanka, janë vërejtur mangësi në drejtim të kontrollit të TIK-së të subjektit nga struktura të pavarura nga ato të përfshira në proceset operationale, nevojën e rishikimit të profileve të përdoruesve dhe ndarjen e detyrave midis proceseve, si dhe hartimin e strategjisë në lidhje me mbështetjen që teknologjia e informacionit do të japë në vitet në vazhdim. Lidhur me rrezikun operacional, nevojitet të krijohen strukturat e nevojshme të menaxhimit të këtij rreziku dhe të hartohen procedurat përkatëse për këtë rrezik, si dhe të monitorohet plotësisht.

### 3.5.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Likuiditeti i sistemit bankar edhe gjatë vitit 2012 u shfaq i kënaqshëm dhe me trend rritës. Ndryshimet rregullatore të hyra në fuqi në fund të vitit 2011, nxitën bankat të shtojnë rezervat e tyre të likuiditetit edhe më tej gjatë vitit 2012. Gjithashtu e kënaqshme vijoi të shfaqej situata e likuiditetit në valutë


të huaj. Sikurse është evidentuar një vit më parë, edhe gjatë këtij viti likuiditeti në monedhë të huaj ka vazhduar të rrisë peshën e tij ndaj totalit të aktiveve likuide të sistemit.

### 3.5.3.1 Depozitat e sistemit

Depozitat e klientëve përbëjnë burimin më të qëndrueshëm të financimit, si dhe atë më të rëndësishëm për sistemin bankar shqiptar. Edhe gjatë vitit 2012, depozituesit kanë vazhduar të rrisin investimin e fondeve të tyre pranë bankave, ku në dhjetor 2012 niveli i tyre arrin 991 miliardë lekë, krahasuar me 924 miliardë lekë një vit më parë. Kjo rritje, e cila përkthehet në 7.3%, evidenton një rënie të ritmit të rritjes së depozitave, të cilat gjatë vitit 2011 u rritën me 13%. Edhe gjatë këtij viti rritjen më të madhe e përjetuan depozitat në valutë të huaj, të cilat, me një rritje prej 41 miliardë lekësh, sollën një ndryshim të strukturës monetare të totalit të depozitave. Tradicionalisht, depozitat në monedhën vendase kanë përbërë shumicën e fondeve të investuara nga klientët në sistemin bankar, ndërkohë që tashmë fondet në valutë të huaj zënë 50.7% të totalit të depozitave, krahasuar me 49.9% të një viti më parë.


Përsa i përket llojit të klientelës, depozitat nga individët përbëjnë pjesën më të madhe të totalit (rreth 88%), ku gjatë këtij viti vetëm individët kanë kontribuar në rritjen e depozitave në total, ndërkohë që sektori privat dhe ai publik zënë vetëm 12% të depozitave të sistemit dhe paraqesin rënie të lehtë. Nga ana tjetër, struktura e maturitetit të depozitave nuk ka ndryshuar dukshëm, ku peshën më të madhe e zënë depozitat që maturohen për 6 deri në 12 muaj.

Grafik 19. Ecuria e depozitave të klientëve (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Struktura e depozitave sipas maturitetit të mbetur.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 22. Ecuria e depozitave për tre monedhat kryesore.

Depozita	Dhjetor 2008	Dhjetor 2009	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012
Depozita në ALL (në milionë lekë)	367,255	376,216	417,963	462,645	489,029
Rënia/Rritja vjetore		8,961	41,747	44,681	26,384
Rënia/Rritja vjetore (%)		2.4	11.1	10.7	5.7
Depozita në EUR (në milionë euro)	1,668	1,801.0	2,376.6	2,750	3,026
Rënia/Rritja vjetore		133	576	373	276
Rënia/Rritja vjetore (%)		8.0	32.0	15.7	10.0
Depozita në USD (në milionë usd)	716	632	574	619	619
Rënia/Rritja vjetore		(83.5)	(58.5)	44.9	0.7
Rënia/Rritja vjetore (%)		(11.7)	(9.3)	7.8	0.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3.5.3.2 Përqendrimi i depozitave

Sikurse edhe zërat e tjerë të bilancit, depozitat e klientëve janë të përqendruara në bankat më të mëdha të sistemit. Konkretisht, 5 bankat më të mëdha mbajnë 74.4% të totalit të depozitave, ku në vitin 2012 kjo shifër paraqitet disi më e ulët se 75% e një viti më parë. Nga ana tjetër, një vështrim mbi përqendrimin e klientëve më të mëdhenj të çdo banke tregon se 20 depozituesit më të mëdhenj për secilën bankë zotërojnë rreth 8% të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë, kur kjo shifër arrinte nivelin prej 9.4%, vihet re një trend rënës i përqendrimin të klientëve më të mëdhenj.


### 3.5.3.3 Aktivet likuide të sistemit

Gjatë vitit 2012, aktivet likuide të sistemit bankar u rritën me 51.7 miliardë lekë duke arritur nivelin 349 miliardë lekë. Pjesën më të madhe të tyre – rreth 55%, e zënë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare, 31% e zënë marrëdhëniet

me institucionet financiare në formën e llogarive rrjedhëse, vendosjeve apo huadhënieve, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga mjetet monetare dhe marrëdhëniet me bankën qendrore (10%), si dhe nga letrat me vlerë të institucioneve jorezidente (4%)<sup>10</sup>.

Ndryshimet rregullative dhe rritja e nivelit minimal të lejuar të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra (ndryshime këto të cilat hynë në fuqi në fund të vitit 2011), vazhduan të kenë impakt në rritjen e likuiditetit të sistemit edhe gjatë vitit 2012. Kështu, në fund të vitit 2012, raporti i aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra arriti nivelin 36.7% (krahasuar me 33.1% të një viti më parë), treguesi në lekë arriti nivelin 45.9% (krahasuar me 43.1%) dhe treguesi në valutë u rrit në 27.5%, kundrejt 22.8% të fundvitit 2011. Kjo rritje, ashtu sikurse edhe një vit më parë,

Grafik 21. Ecuria e aktiveve likuide, strukturës së zërave përbërës së tyre dhe treguesit të likuiditetit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>10</sup> Të gjithë zërat i nënshtrohen reduktimeve përkatëse sipas rregullores "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" nr. 71 datë 14.10.2009, e ndryshuar, në varësi të maturitetit, cilësisë së kundërpatisë, etj.

i atribuohet kryesisht rritjes së aktiveve likuide në monedhë të huaj. Kufijtë minimalë të lejuar nga rregullorja, 25% për treguesin në total dhe 20% për treguesin në monedhën vendase dhe në monedhë të huaj, respektoheshin nga të gjitha bankat e sistemit në fund të vitit 2012.

Grafik 22. Struktura e aktiveve likuide sipas monedhave.



### 3.5.3.4 Hendeku i aktiveve dhe pasiveve


	Dhjetor'11	Mars '12	Qershor'12	Shtator'12	Dhjetor'12
Hendeku i maturimit deri në 1 muaj (në mln lekë)	-47,757	-15,571	8,633	18,876	-33,503
Hendeku i maturimit deri në 3 muaj (në mln lekë)	-113,992	-64,370	-158,725	-63,642	-96,429
Hendeku i maturimit deri në 1 muaj / totali i aktiveve (në %)	-3.7	-1.2	0.7	1.4	-2.6
Hendeku i maturimit deri në 3 muaj / totali i aktiveve (në %)	-9.5	-5.2	-12.5	-4.9	-7.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 23. Hendeku i maturimit deri në një muaj dhe deri në tre muaj për sistemin bankar.

Diferenca midis aktiveve dhe pasiveve me maturitet të mbetur deri në tre muaj shënon një nivel negativ prej 96 miliardë lekësh ose rreth 7% të totalit të aktiveve. Pavarësisht se vazhdojnë të prezantojnë vlera negative, mospërputhjet e maturitetit të aktiveve dhe pasiveve si deri në një muaj, ashtu edhe deri në 3 muaj shfaqen në nivele më të ulëta se një vit më parë, si në vlerë relative, ashtu edhe absolute.

Grafik 23. Hendeku i maturimit deri në tre muaj sipas monedhave, si dhe hendeku sipas shportave të maturitetit.



### 3.5.3.5 Huatë nga bankat dhe institucionet financiare jorezidente

Edhe gjatë vitit 2012, bankat kanë vijuar të marrin financime nga bankat e tyre mëma ose institucione të tjera financiare jorezidente. Këto lloj financimesh luajnë rol të rëndësishëm për disa nga bankat e sistemit, megjithatë edhe gjatë këtij viti huamarrjet nga institucionet jorezidente kanë vazhduar trendin rënës. Kështu, kjo shifër në fund të dhjetorit 2012 zë 1.4% të aktiveve të sistemit bankar dhe 3.3% të aktiveve të grupit të bankave, që financohen nga këto hua. Krahasuar me një vit më parë, edhe gjatë këtij viti vihet re reduktim i këtij niveli, si pasojë e rënies së përdorimit të linjave të kredive të akorduara nga bankat mëma, të disa bankave të sistemit.

Nga ana tjetër, një pjesë e bankave të sistemit kanë të miratuara nga bankat mëma linja kredie ende të papërdorura, evidentuar si zëra jashtë bilancit. Konkretisht këto fonde, në fund të vitit 2012 shënonin rreth 49 miliardë lekë, nga 63 miliardë lekë që shënonin një vit më parë.

Vlen të theksohet se nga këndvështrimi prudencial, ulja e përdorimit të financimeve nga bankat mëma konsiderohet si një zhvillim pozitiv. Kjo, pasi në këtë mënyrë bankat ulin përqendrimin nga një burim i caktuar fondesh dhe rrisin mbështetjen në burime të qëndrueshme financimi, siç janë depozitat e klientëve.

### 3.5.3.6 Treguesi kredi ndaj depozita

Rritja e tepricës së kredisë bruto ka qenë më modeste sesa rritja e depozitave gjatë vitit 2012, çka si rrjedhojë ka ndikuar në një përmirësim të treguesit të likuiditetit strukturor – kredi ndaj depozita. Në fund të vitit 2012, ky raport arriti nivelin prej 58%, i cili krahasuar me 61% të një viti më parë prezanton rënie. Rritja e likuiditetit në monedhë të huaj ka sjellë edhe përmirësimin e treguesit përkatës, i cili ka rezultuar me një rënie prej 9.1 pikë përqindjeje. Niveli i ulët i raportit kredi ndaj depozita dëshmon për një mbulim më të mirë të kredive me fonde të qëndrueshme, siç konsiderohen depozitat e klientëve.

Tabelë 24. Ecuria e treguesit kredi ndaj depozita, në përqindje.

Vitet	Lekë	Valutë	Të gjitha monedhat
2006	17	70	38
2007	22	79	46
2008	30	104	62
2009	36	99	65
2010	35	86	60
2011	39	83	61
2012	41	74	58

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3.5.3.7 Tregu ndërbankar dhe financimet nga Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të injektojë likuiditet në monedhën vendase në treg nëpërmjet instrumentit kryesor dhe instrumenteve rregulluese me afat më të gjatë se një javë. Vihet re se sasia mesatare e likuiditetit të injektuar



nga Banka e Shqipërisë gjatë këtij viti ka qëndruar në nivelin mesatar të vitit të shkuar, 18 miliardë lekë kundrejt 18.4 miliardë lekë në vitin 2011.

Rishpërndarja e likuiditetit brenda sistemit bankar me anë të veprimtarisë së tregut ndërbankar ka vazhduar të kryhet edhe gjatë këtij viti, ku bankat kanë vendosur depozita apo kanë marrë hua mes tyre në monedhën vendase dhe në masë më të vogël në valutë të huaj. Megjithëse vëllimi mesatar i transaksioneve në lekë gjatë vitit 2012 është rritur ndjeshëm krahasuar me një vit më parë (7.11 miliardë lekë kundrejt 2.5 miliardë), vëllimi mesatar i këtyre transaksioneve vijon të mbetet mjaft i vogël, më pak se 1% e totalit të detyrimeve të sistemit.

### 3.5.4 RREZIKU I TREGUT

Mospërputhja midis aktiveve dhe pasiveve sipas afatit të riçmimit tregon për një ekspozim të kufizuar të sistemit bankar ndaj rrezikut të normave të interesit. Diferenca midis aktiveve dhe pasiveve të riçmueshme deri në tre muaj llogaritet në nivelin 43 miliardë lekë ose 4.3% ndaj aktiveve që sjellin të ardhura. Hendeku afatgjatë (deri në 1 vit) shfaqet në kah të kundërt dhe disi më i zgjeruar (83 miliardë lekë), megjithatë *stress test*-et e matjes së ekspozimit ndaj këtij lloji rreziku prezantojnë një ndikim të moderuar të tij ndaj kapitalit rregullator të sektorit bankar. Edhe të analizuar sipas monedhave, këto mospërputhje janë në nivele relativisht të ulëta, megjithëse këtë vit dollari amerikan ka shfaqur një tendencë të lehtë zgjerimi.

Pozicioni i hapur valutor neto i sistemit, në dhjetor 2012, përlllogaritet në blerje në 4.1 miliardë lekë ose shprehur ndryshe 3.98% të kapitalit rregullator të bankave të sistemit. Këto vlera të vendosura kundrejt kufirit rregullator prej 30%, së bashku me rezultatet e analizave të vlerësimit *stress test* të rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit nënkuptojnë ekspozim të ulët të sistemit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.


Kapitali i nevojshëm për të mbuluar rrezikun e tregut përlllogaritet në 1.6 miliardë lekë për fundin e vitit 2012. Kapitali për rrezikun e normës së interesit përfaqëson 70% të kësaj shume, ndërkohë që pjesa tjetër i përket kapitalit për rrezikun e kursit të këmbimit. Norma e përgjithshme e mbulimit me kapital për rrezikun e tregut dhe atë të kredisë për sistemin, përlllogaritet në 136%, lart normës së përgjithshme minimale prej 100%.

## 3.6 MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

### 3.6.1 KAPITALI AKSIONER

Në fund të vitit 2012, kapitali aksioner i sistemit bankar arrin nivelin 101.8 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 4.5 miliardë lekësh (4.7%), përkundrejt rritjes në nivel disi më të ulët prej 4.2 miliardë lekësh (4.5%) gjatë vitit 2011.

Grafik 24. Ecuria e kapitalit aksioner.



Ndryshe nga luhatshmëria e rritjes tremujore të vitit 2011, gjatë vitit 2012 rritja e kapitalit aksioner ka qenë e njëtrajtshme dhe e shpërndarë në mënyrë pothuaj të barabartë përgjatë gjithë vitit.

Komponenti me ndikim më të madh material në rritjen e kapitalit aksioner është kapitali i paguar, i cili është rritur me rreth 9,6 miliardë lekë (11.5%), duke sjellë edhe rritje të peshës të këtij komponenti në 90.7% kundrejt 85.1% të vitit 2011. Ky zhvillim është tregues i gatishmërisë së aksionerëve për të mbështetur aktivitetin bankar me burimin e nevojshëm të kapitalit.


Tabelë 25. Struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij.

Treguesit	Dhjetor 2012		Dhjetor 2011		Dhjetor 2010		Dhjetor 2009	
	mln lekë	%	mln lekë	%	mln lekë	%	mln lekë	%
Kapitali aksioner	101,841.1	100.0	97,304.7	100.0	93,138.4	100	84,846.8	100
Kapitali i paguar	92,356.6	90.7	82,803.9	85.1	70,742.0	75.95	60,867.3	71.74
Primet e aksioneve	4,657.8	4.6	4,180.1	4.3	3,703.4	3.98	3,703.4	4.36
Rezervat	9,558.7	9.4	13,639.6	14.0	8,486.4	9.11	7,434.7	8.76
Diferencë rivlerësimi	1,991.3	2.0	2,292.0	2.4	1,618.9	1.74	211.6	0.25
Fitim/humbje e pashpërndarë	(10,491.8)	(10.3)	(6,317.2)	(6.5)	1,872.6	2.01	9,085.2	10.71
Fitim/humbje e periudhës	3,768.6	3.7	706.3	0.7	6,715.1	7.21	3,544.5	4.18

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3.6.2 RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Grafik 25. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe komponentëve të saj.



Përkundrejt minimumit rregullator të kërkuar prej 12%, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si tregues thelbësor mbikëqyrës, në fund të vitit 2012 raportohet në nivelin 16.2%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ky tregues shfaqet me një rritje prej 0.6 pikë përqindjeje, ndërkohë që paraqitet në nivel të ngjashëm me fundin e vitit 2010, tregues ky i qëndrueshmërisë së nivelit të kapitalizimit.

Gatishmëria dhe mbështetja me kapital e aksionerëve përgjatë vitit 2012, ka sjellë një normë rritjeje të kapitalit rregullator të sistemit me 5.7%, përkundrejt normës së rritjes prej 1.7% të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik.

## 3.6.3 KAPITALI RREGULLATOR


Kapitali rregullator i sistemit bankar evidentohet në nivelin 104.1 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2011, kapitali rregullator shfaq një rritje prej 5.6 miliardë lekësh (5.7%).

Kapitali bazë i sistemit bankar përbën komponentin kryesor të kapitalit rregullator të sistemit me një peshë prej 90%, çka tregon për një kapital rregullator cilësisht të qëndrueshëm me gjithë rënien prej rreth 2 pikë përqindjeje krahasuar me vitin e kaluar.

Kapitali shtesë i sistemit, i cili përbëhet nga borxhi i varur, llogaritet në nivelin 10.3 miliardë lekë, kundrejt 7.99 miliardë lekë në fund të vitit 2011. Numri i bankave me borxh të varur arrin në gjashtë kundrejt shtatë bankave në fund të vitit 2011.

Kredia me probleme neto në raport me kapitalin rregullator të sistemit përlllogaritet në 55.6% kundrejt 52% në fund të vitit të kaluar. Rritja vjetore e treguesit është rrjedhojë e rritjes së kredisë me probleme neto me ritme më të larta se ajo e kapitalit rregullator.

Grafik 26. Kredia me probleme neto / kapitali rregullator.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 3.6.4 TOTALI I AKTIVEVE DHE ZËRAVE JASHTË BILANCIT

Totali i aktiveve dhe i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik u rritën me rreth 11 miliardë lekë (1.73%) gjatë vitit 2012. Ndikimin më të madh në rritjen e tyre e kanë dhënë rritja me rreth 56.8 miliardë lekë (42.1%) e aktiveve me rrezik të ulët dhe rritja me rreth 20.4 miliardë lekë (6%) e aktiveve me rrezik të lartë. Të dhënat gjatë vitit 2012 tregojnë një rënie të aktiveve të ponderuara me 150% prej rreth 15 miliardë lekësh (9.8%).


Tabelë 26. Ecuria e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut të sistemit bankar.

Treguesit (në milionë lekë)	Dhjetor 2012	Dhjetor 2011	Dhjetor 2010	Dhjetor 2009	Dhjetor 2008	Dhjetor 2007
Aktive pa rrezik	457,736.1	450,321.4	409,673.9	381,448.4	334,268.2	324,678.1
Aktive me rrezik të ulët	191,600.9	134,820.5	95,701.9	58,545.4	54,651.4	88,391.6
Aktive me rrezik të mesëm	27,573.4	31,091.0	34,354.0	32,814.7	17,842.4	18,877.8
Aktive me rrezik të lartë	360,466.0	340,090.6	262,324.9	282,952.7	240,382.5	196,944.8
Aktive me 150%	137,241.6	152,242.8	178,050.0	118,378.6	41,540.5	21,440.5
ZJB të ponderuara me rrezik	25,254.8	21,784.2	20,303.4	14,209.0	17,660.7	14,233.1
Aktivet dhe ZJB të ponderuara me rrezik	643,690.1	632,748.7	586,020.7	502,846.6	340,205.4	270,456.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik kanë vijuar të rriten edhe gjatë vitit 2012 me një vlerë prej 3.4 miliardë lekësh. Megjithatë, pesha e tyre shfaqet relativisht e parëndësishme kur në fund të vitit 2012 ato përbëjnë rreth 4% të totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të sistemit bankar.

Grafik 27. Zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik.



## 3.6.5 TREGUESIT E RENTABILITETIT

## 3.6.5.1. Rezultati neto dhe struktura e tij

Rezultati financiar i vitit 2012 ishte pozitiv me një vlerë prej rreth 3.8 miliardë lekësh, rezultat ky disa herë më i lartë se ai i vitit 2011 me rreth 706 milionë lekë. Ndikim të ndjeshëm në rritjen e rezultatit financiar ka pasur rritja e fitimeve nga veprimtaria me letra me vlerë e bankave.

Brenda vitit 2012, ndikimin më të madh në rezultatin financiar e ka dhënë gjashtëmujori i parë me një rezultat financiar neto prej rreth 2.4 miliardë lekësh. Kjo vjen për arsye të rritjes më të madhe të shpenzimeve për provigjione të bankave në gjashtëmujorin e dytë të vitit.

## 3.6.5.2. Treguesit e përfitueshmërisë

Si rrjedhojë e rezultatit financiar pozitiv më të lartë se vitin e kaluar, edhe ecuritë e treguesve kryesorë të përfitueshmërisë, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali aksioner mesatar (RoAE) shfaqen në rritje gjatë vitit 2012. Vlerat në fund të vitit 2012 shfaqen në 0.33% për RoAA dhe 3.78% për RoAE në krahasim me përkatësisht 0.07% dhe 0.76% për vitin 2011.

Tabelë 27. Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë, në përqindje (kumulative).

Treguesit	Dhjetor 2012	Qershor 2012	Dhjetor 2011	Qershor 2011	Dhjetor 2010
RoAA	0.33	0.42	0.07	0.22	0.72
RoAE	3.78	4.79	0.76	2.43	7.58

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli i treguesve në gjashtëmujorin e parë të vitit paraqitet më i lartë për shkak të rritjes më të ulët të kapitalit të bankave në gjashtëmujorin e dytë.

Dy tabelat në vijim shfaqin përfitueshmërinë e sistemit bankar nga veprimtaria kryesore si dhe dinamikën e ekuilibrit ndërmjet mbledhjes së burimeve për të cilat paguhet interes dhe investimit në aktive që gjenerojnë interesa.

Tabelë 28. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore, në përqindje (kumulative).

Treguesit	Dhjetor 2012	Qershor 2012	Dhjetor 2011	Qershor 2011	Dhjetor 2010
Të ardhurat nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura(1)	7.73	7.76	7.78	7.74	8.11
Shpenzime për interesa/aktive mesatare që sjellin të ardhura(2)	3.72	3.72	3.57	3.53	3.78
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) - (2)]	4.01	4.04	4.20	4.21	4.32

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2012, veprimtaria bankare e bazuar në instrumente që gjenerojnë interesa ka qenë disi më e balancuar në krahasim me vitin paraardhës kur marzhi neto nga interesat ka një ulje prej 0.2 pikë përqindjeje. Kjo vjen si pasojë e ritmit më të ulët të kreditimit në vend, ndërkohë që depozitat kanë pësuar rritje, si dhe njëkohësisht për shkak të rritjes së veprimtarisë bankare në letra me vlerë.

Tabelë 29. Treguesit mesatarë të përfitueshmërisë, në milionë lekë.

Treguesit	Tremujori IV 2012	Tremujori II 2012	Tremujori IV 2011	Tremujori II 2011	Tremujori IV 2010
Aktivet mesatare që sjellin të ardhura (1)	992,250.7	977,479.7	943,023.2	919,154.9	855,368.2
Pasivet mesatare që shkaktojnë shpenzime (2)	994,957.7	974,208.4	889,977.2	857,874.7	794,879.1
Aktivet mesatare (3)	1,157,648.7	1,135,073.7	1,050,371.2	1,013,594.4	938,695.7
(1) / (3)	86%	86%	90%	91%	91%
(2) / (3)	86%	86%	85%	85%	85%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e veprimtarisë bankare në letra me vlerë konstatohet edhe në rënien e peshës së aktiveve dhe pasiveve që gjenerojnë të ardhura ndaj aktiveve të sistemit për vitin 2012. Dinamika e peshës së instrumenteve bankare që gjenerojnë të ardhura ndaj totalit të aktiveve duket se ka qenë konstante gjatë vitit 2012, ndërkohë që konstatohet rënie e instrumenteve aktive që gjenerojnë të ardhura në krahasim me vitin 2011.

Treguesi i efikasitetit të sistemit në fund të vitit 2012 është rritur me rreth 4 pikë përqindje në krahasim me vitin paraardhës, në kushtet kur shpenzimet operacionale janë rritur më shpejt se të ardhurat operacionale.

Tabelë 30. Ecuria e treguesit të efikasitetit në milionë lekë.

Treguesit	Dhjetor 2012	Qershor 2012	Dhjetor 2011	Qershor 2011	Dhjetor 2010
Shpenzime operacionale (1)	25,930.6	12,264.7	24,490.7	11,657.9	23,491.2
E ardhura operacionale* (2)	39,328.6	17,277.2	39,636.0	22,037.6	44,193.2
Efikasitetit (1) / (2)	66%	71%	62%	53%	53%

\* Të ardhurat neto nga interesi + të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 3.7 INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA DHE SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT

### 3.7.1 SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA

Viti 2012 vijoi me zgjerimin e subjekteve financiare jobanka (SFJB), në numër institucionesh dhe në veprimtari të reja financiare për tregun vendas. Numri i subjekteve arriti në 21 nga 19 që regjistroheshin një vit më parë. Risi në treg ka qenë veprimtaria financiare e këshillimit për shërbime të këmbimit valutor. Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, mund të ushtrojnë më shumë

se një veprimtari financiare. Subjektet financiare jobanka të grupuara sipas aktiviteteve financiare kryesore për të cilat janë licencuar klasifikohen në:

- Institucione që ushtrojnë veprimtarinë financiare të “kredidhënies”: Fondi Besa sh.a, NOA sh.a, Shoqëria e parë financiare e zhvillimit –FAF sh.a, dhe Tranzit sh.p.k.;
- Institucione që ushtrojnë veprimtarinë financiare të “mikrokredisë”: VisionFund Albania sh.p.k. dhe Capital Invest sh.a.;
- Institucione që ushtrojnë veprimtarinë financiare të “qirasë financiare”: Raiffeisen Leasing sh.a., Tirana Leasing sh.a., Credins Leasing sh.a., Landeslease sh.a., Fin-al sh.p.k. dhe Sogelease sh.a.;
- Institucione që ushtrojnë veprimtarinë financiare të “ofrimit të shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave”: Posta Shqiptare<sup>11</sup>, Unioni financiar i Tiranës sh.p.k., Ak-Invest sh.a., Easy pay sh.p.k., dhe M-pay sh.p.k.;
- Institucione që ushtrojnë veprimtarinë financiare të “faktoringut”: Albanian Factoring Services (AFS) sh.a., Omnifactor sh.p.k. dhe Zig Factoring sh.p.k.;
- Institucione që ushtrojnë veprimtarinë financiare të “shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera për këmbimin valutor”: Platinum Investment sh.p.k.

### 3.7.1.1 Ecuria e aktiveve

Në dhjetor 2012, niveli i aktiveve të subjekteve financiare jobanka regjistron vlerën 29.96 miliardë lekë, duke përbërë 2.5% të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Zhvillimi i këtij tregu ka qenë në nivele më të ulëta se ai i sistemit bankar duke ndikuar në reduktimin e peshës së tij ndaj sistemit me 0.2 pikë përqindje gjatë vitit 2012. Aktivitetet e subjekteve financiare jobanka kanë regjistruar një rënie të lehtë me rreth 0.3% ose me 0.1 miliardë lekë.

Tabelë 31. Totali i aktiveve të SFJB-ve të ndara sipas aktivitetit kryesor të tyre, për periudhën dhjetor 2011 - dhjetor 2012 (në miliardë lekë).

	Dhjetor '11	Mars'12	Qershor'12	Shtator'12	Dhjetor'12
SFJB të kredidhënies	13.70	12.49	12.52	12.73	13.03
SFJB të qirasë financiare	10.99	11.25	10.88	10.88	10.49
SFJB të shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave	4.9	4.68	5.02	5.04	5.83
SFJB të mikrokredisë	0.38	0.37	0.39	0.41	0.35
SFJB të faktoringut	0.09	0.13	0.13	0.15	0.23
SFJB të shërbimit këshillues/ndërmjetës për këmbimin valutor	n/a	n/a	n/a	0.01	0.01
Totali i aktiveve të SFJB	30.06	28.92	28.94	29.21	29.96

Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

Megjithë shtimin e subjekteve të reja, totali i aktiveve të subjekteve financiare jobanka paraqitet me një rënie të lehtë krahasuar me fundvitin 2011. Ky

<sup>11</sup> Në këtë analizë nuk janë përfshirë të dhënat për subjektin Posta Shqiptare (PSH) në ecurinë e subjekteve të shërbimit të pagesave dhe transfertave, dhe në totalin e subjekteve financiare jobanka.

trend është ndikuar kryesisht nga tkurrja e aktiveve të subjekteve kredidhënëse dhe të qirasë financiare si dhe është zbutur nga rritja graduale e subjekteve financiare jobanka të cilat ofrojnë shërbimin e pagesave dhe të transfertave. Reduktimi i aktiveve të subjekteve jobanka të cilat ushtrojnë veprimtarinë kredidhënëse ka ardhur si rezultat i përkeqësimit të cilësisë së portofolit. Ndërkohë, zvogëlimi i aktivitetit të qirasë financiare është diktuar kryesisht nga reduktimi i investimeve të biznesit. Në vijim, subjektet e faktoringut paraqiten me një rritje modeste të bilancit.

Portofoli i kredisë përbën pjesën kryesore të aktiveve në subjektet financiare jobanka, me 62.1%. Ai dominohet nga portofoli i kredidhënies dhe mikrokredisë (56.8%), ndjekur nga portofoli i qirasë financiare (42.8%) dhe një pjesë të vogël e zë portofoli i faktoringut (0.4%).

Subjektet financiare jobanka financohen nga huamarrjet, me 58.7% dhe nga kapitali i tyre me 34.6%. Rreth 69% e huamarrjeve janë origjinuar në tregun vendas.

Gjatë vitit 2012, SFJB-të paraqiten të mirëkapitalizuara dhe në përputhje me kërkesat rregullative në bazë të aktivitetit që ato ushtrojnë. Në disa raste, SFJB-të kanë rritur kapitalin e paguar me kërkesë të Departamentit të Mbikëqyrjes, të Bankës së Shqipërisë.

### 3.7.2 ZHVILLIMET NË TEPRICËN E PORTOFOLIT TË KREDISË

Tabelë 32. Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e SFJB-ve, për periudhën dhjetor '11- dhjetor '12, në miliardë lekë.

	Dhjetor'11	Mars'12	Qershor'12	Shtator'12	Dhjetor'12
Total portofoli i kredisë për SFJB-të (neto)	18.86	18.98	18.9	18.62	18.61
Total portofoli i kredisë për SFJB-të (bruto)	20.04	20.20	20.30	20.19	20.04

Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

Në dhjetor 2012, portofoli i kredisë bruto për subjektet financiare jobanka shënon nivelin prej 20.04 miliardë lekësh. Gjatë vitit, luhatjet në portofolin e kredisë kanë qenë minimale, duke mbetur pothuaj në nivele statike në fund të vitit 2012. Ky trend është përcaktuar nga tkurrja e portofolit të qirasë financiare dhe rritja minimale e portofolit të kredidhënies. Portofoli i kredisë të SFJB-ve përbën rreth 3.47% ndaj totalit të kredisë së sistemit bankar. Falë edhe ritmit të moderuar rritës të kredidhënies bankare gjatë vitit 2012, ky raport ka mbetur pothuaj i pandryshuar, krahasuar me një vit më parë (2011: 3.54%).

Struktura e portofolit të kredisë mbetet e pandryshuar, ku në fokus mbetet kreditimi i biznesit (90.0%) dhe brenda tij sektorët: "Tregti, riparim i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë" (25.4%), "Ndërtim" (10.3%), dhe "Bujqësi, gjueti dhe silvikulturë" (9.4%). Analiza sipas monedhës evidenton se 55.5% e portofolit të kredisë së SFJB-ve është në monedhën vendase dhe 44.5% në

valutë. Brenda këtij portofoli dallojmë se kreditimi nëpërmjet qirasë financiare është i orientuar drejt valutës, kredidhënia e SFJB-ve të kredidhënies dhe mikrokredisë është e përqendruar në monedhën vendase, ndërsa shërbimi faktoring paraqitet i ndarë ndërmjet monedhës vendase dhe valutës. Së fundmi, portofoli i mbarë SFJB-ve paraqet maturitet afatmesëm (75.6%).

Tabelë 33. Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë për periudhën dhjetor '11 - dhjetor '12 (në përqindje).

	Dhjetor'11	Mars'12	Qershor'12	Shtator'12	Dhjetor'12
Kredi me probleme/teprica e kredisë (bruto)	7.12	7.92	8.99	10.39	8.37
Kredi me probleme/teprica e kredisë (neto)	3.04	3.62	3.83	4.46	3.12

Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i kredive me probleme (bruto) për SFJB-të është rritur me ritme më të ngadalta krahasuar me një vit më parë. Kreditë me probleme (bruto) janë rritur me rreth 0.16 miliardë lekë ndërkohë që portofoli ka mbetur në nivele statike. Gjatë vitit 2012, ndër kreditë me probleme, kreditë e klasifikuara "të humbura" kanë pësuar rritjen më të madhe (me 0.22 miliardë lekë). Duhet theksuar se SFJB-të, kryesisht ato të kredidhënies dhe mikrokredisë, janë aktive në fshirjen e kredive me probleme. Gjithashtu, treguesi i kredive me probleme në tregun financiar jobankar paraqitet në vazhdimësi më i ulët krahasuar me sistemin bankar.

### 3.7.3 REZULTATI FINANCIAR

Në vitin 2012, tregu financiar jobankar paraqitet me një performancë financiare pozitive në vlerën 877 milionë lekë<sup>12</sup>. Ndonëse SFJB-të rezultojnë me një peshë të vogël të aktiveve ndaj sistemit bankar, performanca financiare e tyre paraqitet e konsiderueshme krahasuar me atë të sistemit, në masën 23%. Institucionet e shërbimit të pagesave dhe transfertave si dhe ato të qirasë financiare, vijojnë të paraqiten më fitimprurëset ndër SFJB-të. Institucionet e kredidhënies dhe mikrokredisë shfaqen me rezultat financiar të përmirësuar në vijim të rikuperimit të kredive me probleme.

Të gjitha grup subjektet paraqesin rezultat neto pozitiv me përjashtim të institucionit të shërbimeve këshilluese dhe ndërmjetëse për veprimtarinë valutore, i cili është licencuar në gjashtëmuajorin e dytë 2012. Në përgjithësi, performanca financiare e SFJB-ve ka shfaqur shenja ngadalësimi krahasuar me një vit më parë, me rreth 4.8%, si rezultat i nivelit të performancës të subjekteve të pagesave dhe transfertave dhe atyre të qirasë financiare, të cilat japin kontributin kryesor në rezultatin neto të SFJB-ve, përkatësisht 61.6% dhe 24.5%.

<sup>12</sup> Në rezultat nuk përfshihet rezultati financiar i Postës Shqiptare.



## 3.8 UNIONET FINANCIARE DHE SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT

### 3.8.1 STRUKTURA E UNIONEVE TË RRJETIT TË SHKK-VE

Rrjeti i shoqërive të kursim-kreditit në dhjetor 2012 përbëhet nga dy unionet e shoqërive të kursim-kreditit (Unioni "Jehona" dhe Unioni Shqiptar i Shoqërive të Kursim-Kreditit) dhe nga dy SHKK të pavarura (SHKK Elbasan dhe SHKK Perlat).

	Dhjetor 2011		Qershor 2012		Dhjetor 2012	
	Totali i SHKK-ve	Totali i anëtarëve	Totali i SHKK-ve	Totali i anëtarëve	Totali i SHKK-ve	Totali i anëtarëve
Totali i rrjetit të SHKK-ve	126	44,638	126	46,420	126	48,092

Burimi: Departamenti i Statistikave.

Tabelë 34. Ecuria e numrit të SHKK-ve dhe anëtarësimeve, për periudhën dhjetor '11-dhjetor '12.

Anëtarësia ka vijuar të zgjerohet gjatë vitit 2012, ndërsa numri i SHKK-ve ka mbetur konstant. Gjatë vitit, shoqëritë e kursim – kreditit kanë punuar me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për përfshirjen e tyre në skemën e sigurimeve brenda vitit 2013.

### 3.8.2 ECURIA E AKTIVEVE TË UNIONEVE DHE RRJETIT TË SHKK-VE

	Dhjetor '11	Qershor '12	Dhjetor '12
Unionet	4.64	4.65	5.35
Rrjeti i SHKK-ve	5.16	5.25	5.22

Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

Tabelë 35. Ecuria e aktiveve të unioneve dhe rrjetit të SHKK-ve për periudhën dhjetor '11-dhjetor '12 (në miliardë lekë).

Totali i aktiveve të unioneve dhe rrjeteve të SHKK-ve është rritur gjatë vitit 2012, respektivisht 15.3% dhe 1.2%. Rritja e konsiderueshme e aktiveve të unioneve është pasojë e rritjes së investimeve në aksione bankare. Ndërkohë që rrjeti i SHKK-ve, edhe këtë vit, paraqitet sërish me rritje minimale. Totali i aktiveve të unioneve dhe të rrjetit të SHKK-ve përbëjnë rreth 0.44% të totalit të aktiveve të sistemit bankar.

Aktivet e unioneve janë të orientuara drejt "Veprimeve me klientë", me 47%, dhe në investimet në aksione bankare dhe bono thesari me 30%. Ndërsa, struktura e aktivitetit të rrjetit të SHKK-ve mbetet e orientuar në kredidhënien drejt anëtarëve, me 83%.

### 3.8.3 ZHVILLIMET NË TEPRICËN E PORTOFOLIT TË KREDISË

	Dhjetor'11	Qershor'12	Dhjetor'12
Kredia bruto			
Unionet	2.60	2.65	2.54
Rrjeti i SHKK-ve	4.52	4.61	4.58
Kredia neto			
Unionet	2.54	2.63	2.51
Rrjeti i SHKK-ve	4.31	4.38	4.32

Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

Tabela 36. Ecuria e portofolit të kredisë bruto dhe neto, për totalin e unioneve dhe rrjetit të SHKK-ve për periudhën dhjetor '11- dhjetor '12 (në miliardë lekë).

Në dhjetor 2012, portofoli total i kredisë (bruto) për rrjetin e SHKK-ve (duke përfshirë edhe SHKK-të e pavarura) arrin në 4.58 miliardë lekë dhe përbën 0.79% ndaj totalit të kredisë së sistemit bankar. Rritja e portofolit të rrjetit vijon të mbetet minimale edhe gjatë vitit 2012, me një ritëm rritjeje rreth 1.3% ose vetëm 60 milionë lekë. Për sa i përket cilësisë së portofolit, gjatë vitit vërehet një përkeqësim i treguesit të kredive me probleme bruto, duke arritur në nivelin 7% për mbarë rrjetin e SHKK-ve (dhjetor'11: 5.8%). Ky tregues është rritur si pasojë e rritjes së kredive me probleme. Përkeqësimi i portofolit të rrjetit ka dhënë efekt edhe në përkeqësimin e treguesit të cilësisë së kredisë për unionet me 2.2 pikë përqindje (nga 2.1% në 4.3%). Megjithatë, cilësia e kredisë në rrjetin e SHKK-ve paraqitet më pozitive në krahasim me sektorin financiar jobankar dhe atë bankar.

#### 3.8.4 REZULTATI FINANCIAR I UNIONEVE DHE RRJETIT TË SHKK-VE

Në dhjetor 2012, rrjeti i SHKK-ve, rezulton me një rezultat negativ në masën 47.78 milionë lekë, kryesisht si pasojë e përkeqësimit të cilësisë së kredisë. Unionet paraqiten me rezultat financiar pozitiv, në vlerën 7.1 milionë lekë, por ky rezultat është tkurrur ndjeshëm krahasuar me një vit më parë (rreth 75% ose me 21.7 milionë lekë) kryesisht si pasojë e rritjes së kredive me probleme dhënë SHKK-ve të rrjetit.

## 4 MBIKËQYRJA NË VEND

### 4.1 EKZAMINIMET NË VEND

Funksioni i mbikëqyrjes në vend, është konceptuar si përgjegjësi kryesore e Zyrës së Menaxherëve të Portofolit, e cila vlerëson profilin e rrezikut të subjekteve të licencuara në portofolin e saj, kjo në bashkëpunim me sektorët e profilizuar sipas rreziqeve. Mbikëqyrja e subjekteve ka pasur si objektiv garantimin e zhvillimit të një aktiviteti të shëndoshë financiar brenda kërkesave të kuadrit ligjor e rregullativ mbikëqyrës. Organizimi i punës ka qenë rezultat i kombinimit të nevojave për ekzaminim bazuar në ciklin mbikëqyrës të vendosur nga politika operative e mbikëqyrjes dhe rëndësinë e problematikave në banka të veçanta me përdorimin me efektivitet të burimeve njerëzore në dispozicion. Krahas ekzaminimeve të plota janë kryer edhe një sërë ekzaminimesh të tjera për të adresuar problematika të veçanta, të përbashkëta me autoritete të tjera me të cilat bashkëpunon Banka e Shqipërisë.

#### 4.1.1 EKZAMINIMET E SUBJEKTEVE FINANCIARE

Ekzaminimet në vend të kryera gjatë vitit 2012 kanë patur kryesisht si qëllim vlerësimin e plotë të profilit të rrezikut të subjekteve, pa lënë mënjanë dhe ekzaminimet e iniciuara si rrjedhojë e shfaqjes së fenomeneve të veçanta në subjektet e licencuara. Kështu, gjatë vitit 2012 janë kryer 10 ekzaminime të plota të bankave, 1 ekzaminim i një subjekti jobankë, si dhe 1 ekzaminim i pjesshëm i subjekteve bankare me tematikë realizimin e rekomandimeve për transparencën, ku rekomandimet e Bankës së Shqipërisë rezultuan të përmbushura.

Ekzaminimet në vend e kanë vënë theksin në inkurajimin dhe orientimin e bankave drejt forcimit të strukturave drejtuese, kryesisht atyre të lidhura me sistemet e kontrollit dhe të menaxhimit të rrezikut. Aftësia e strukturave drejtuese për të qeverisur bankat dhe për të siguruar një administrim të kujdesshëm të rreziqeve ka qenë në fokus të strategjisë mbikëqyrëse. Bankave iu është kërkuar hartimi i strategjive afatmesme dhe identifikimi i instrumenteve konkrete për realizimin e tyre.

Problemet e evidentuara nga ekzaminimet mund t'i kategorizojmë si më poshtë:

- Probleme në zbatimin e rregulloreve. Sistemi bankar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ mbikëqyrës. Megjithatë, dobësi janë evidentuar në disa drejtime, të cilat detajohen më poshtë:
  - Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Janë evidentuar kredi të klasifikuara në klasa me rrezik më të ulët se sa parashikohet në kërkesat rregullore e për rrjedhojë pamjaftueshmëri e fondeve rezervë të krijuara për mbulimin e humbjeve. Një problem që ndeshet shpesh është edhe mungesa e dokumentacionit që justifikon riklasifikimin e klientit në klasa me rrezik më të ulët. Rekomandimet kanë synuar edhe të nxisin përmirësimin e politikave e të procedurave që mbulojnë aktivitetin kreditues, forcimit të kapaciteteve analizuese të strukturës së rrezikut të bankës si dhe përmirësimin të analizës së gjendjes financiare të kredimarrësit gjatë procesit të miratimit të kredisë.
  - Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”. Janë evidentuar pasaktësi në klasifikimin e zërave të aktivitetit dhe ponderimin e tyre në përputhje me kategorinë e rrezikut që ato mbartin.
  - Rregullorja “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”. Janë evidentuar vonesa në plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin paraprak të administratorëve nga Banka e Shqipërisë.
  - Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”. Janë evidentuar mangësi në politikat dhe procedurat e brendshme të subjekteve për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Nuk është respektuar periodiciteti i kryerjes së analizave *stress-test*, me qëllim identifikimin dhe matjen e ekspozimit të subjektit ndaj rrezikut të likuiditetit, si në kushte normale po ashtu edhe në situata jo të zakonshme.
  - Rregullorja “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Rastet e evidentuara i referohen përmirësimin të vlerësimit të rrezikut të TIK-së, duke përfshirë klasifikimin e sistemeve e aplikimeve të përdorura dhe identifikimin e dobësive dhe kërcënimeve të mundshme, përmirësimin të planeve të vazhdimësisë së biznesit bazuar në madhësinë dhe kompleksitetin e subjektit, rishikimit të të drejtave të përdoruesve për të siguruar ndarje të përshtatshme të përgjegjësisë dhe sigurimin e hallkave të nevojshme të kontrollit, si dhe kufizimin e aksesit për persona të jashtëm, dokumentimit të proceseve, plotësimin të kuadrit të brendshëm rregullativ të bankës, etj.
  - Rregulloret për transparencën dhe publikimet. Janë evidentuar raste sporadike kur nuk janë zbatuar kërkesat e rregulloreve të mësipërme gjatë hartimit të kontratave, dhënies së informacionit për klientët, publikimit të informacionit, etj.
  - Rregullorja “Mbi standardet minimale të administrimit të rrezikut operacional”. Administrimi i këtij rreziku është një proces relativisht

i ri si për bankat, ashtu edhe për autoritetin mbikëqyrës. Në këto kushte mangësitë kryesore lidhen me plotësimin e politikave dhe procedurave, përcaktimin e treguesve dhe të limiteve të lejuara të tyre, identifikimin e zërave të bilancit që duhen analizuar, etj.

- Rregullorja “Për funksionimin e regjistrimit të kredive në Bankën e Shqipërisë”. Problemet lidhen me gabimet në hedhjen e të dhënave sipas skedarëve.
- Probleme që lidhen me orientimin strategjik të bankave. Pjesa më e madhe e bankave të sistemit janë filiale të grupeve të huaja bankare dhe si të tilla orientimet strategjike i marrin nga grupet përkatëse. Gjatë ekzaminimeve është evidentuar nevoja për të kristalizuar një orientim të qartë strategjik, minimalisht afatmesëm, ku të përcaktohen objektivat e bankës për pozicionimin në treg (total aktivi, kredi, depozita, kredi me probleme, etj.) dhe të identifikohen mjetet dhe burimet e nevojshme për të arritur këto objektiva.
- Probleme që lidhen me organizimin dhe menaxhimin e bankave. Nën ndikimin e efekteve të krizës dhe faktorëve që i shkaktuan ato, një rëndësi gjithnjë e më e madhe i është kushtuar, gjatë ekzaminimeve, mënyrës së organizimit dhe cilësisë së menaxhimit. Në këtë kontekst janë lënë rekomandime për ndarjen e qartë dhe të përshtatshme të detyrave dhe përgjegjësiave dhe sigurimin e hallkave të kontrollit në çdo pjesë të proceseve, përcaktimin e një strukture hierarkike të qartë, me të cilën të orientohet edhe sistemi i pagave dhe shpërblimeve, krijimin e një sistemi korrektues eficient që kufizon në minimum përsëritjen e shkeljeve, plotësimin e kuadrin të brendshëm rregullativ, sigurimin e pavarësisë/burimeve/mbështetjes së mjaftueshme për funksionet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rreziqeve, etj.

## 4.2 PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE TRANSPARENCA

### 4.2.1 INSPEKTIVE TË KRYERA GJATË VITIT 2012

Përtej analizave nga jashtë, Departamenti i Mbikëqyrjes ka marrë pjesë edhe në inspektive në vend, të zhvilluara në banka dhe në subjekte financiare jobanka dhe zyra të këmbimit valutor (ZKV). Kështu gjatë vitit, Departamenti ka qenë pjesë e inspektiveve në vend në 11 banka, 3 subjekte financiare jobanka, 1 shoqëri kursim-kreditit dhe 5 ZKV për përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullativ, si dhe transparencën dhe parandalimin e pastrimit të parave (PPP) dhe financimit të terrorizmit (PFT).

### 4.2.2 PËRPUTHSHMËRIA E SUBJEKTEVE BANKA DHE JOBANKA ME KUADRIN RREGULLATIV TË PPP DHE TRANSPARENÇËS

Sistemi bankar vlerësohet se përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë që mbulon çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe transparencës. Më konkretisht:

## 4.2.3 PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

Procesi mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë edhe gjatë këtij viti, në bankat tregtare, në subjektet financiare jobanka dhe ZKV (zyra këmbimi valutor), një rëndësi të veçantë i ka kushtuar çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës së financimit të terrorizmit. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe bazën rregullative për problemet e parandalimit të pastrimit të parave dhe konkretisht të ligjit<sup>13</sup> sollën domosdoshmërinë e marrjes së masave për implementimin e këtyre ndryshimeve si dhe për të monitoruar, konstatuar dhe analizuar aktivitetin dhe transaksionet e dyshimta. Në këtë kuadër, si dhe të harmonizimit të legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë (Moneyval i KE), gjatë kësaj periudhe, një grup pune i ngritur në muajin maj 2012, ka përfunduar rishikimin e rregullores nr. 44, datë 10.06.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave" në përputhje me ndryshimet ligjore "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", si dhe është në fazën e finalizimit të udhëzimit për matjen e rrezikut të PPP/PFT, i cili do të realizojë klasifikimin e rrezikut për klientët, produktin, shërbimin, llojin e transaksionit, pozitën gjeografike etj. Ky udhëzim do të shërbejë si një guidë për subjektet nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë, për krijimin e parimeve, metodologjive të menaxhimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Nga procesi mbikëqyrës lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka rezultuar se subjektet kanë ndërmarrë masat parandaluese në drejtim të krijimit të strukturave të përshtatshme dhe hartimit të politikave të brendshme si dhe për krijimin e një sistemi funksional për përmbushjen e vigjilencës së zgjeruar për kategoritë e klientëve me rrezik të lartë me qëllim rritjen në numër të raportimeve të transaksioneve të dyshimta dhe të cilësisë së tyre. Megjithatë, janë evidentuar edhe mangësi, të cilat në përgjithësi, kanë konsistuar në pamjafueshmëri të sistemeve efektive të menaxhimit të rrezikut, veçanërisht për kategoritë e klientëve dhe transaksioneve që kërkojnë vigjilencë të zgjeruar. Në kuadër edhe të vëmendjes së lartë që Banka e Shqipërisë i ka kushtuar rritjes së numrit dhe të cilësisë së RAD-ve (Raportimi i Aktiviteteve të Dyshimta), problematikat e evidentuara kanë çuar në lënien e rekomandimeve nga ana e Bankës së Shqipërisë, disa prej të cilave, kanë konsistuar në:

- Krijimin e një strukture të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me qëllim funksionimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore në mënyrë të plotë;
- Rishikimin e burimeve njerëzore në dispozicion për kryerjen, frekuencën dhe cilësinë e trajnimeve dhe zgjerimin e tematikës së trajnimeve edhe me tipologji të ndryshme RAD;
- Zgjerimin e fokusit të kontrollit të brendshëm duke përfshirë vigjilencën e duhur dhe të zgjeruar, si dhe në identifikimin e rasteve të dyshimta dhe analizën e tyre;
- Përmirësimin e procesit të monitorimit, në drejtim të vigjilencës së zgjeruar, procese të cilat duhet të reflektohen në rezultate të matshme sasiore dhe cilësore.

<sup>13</sup> Ligji 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar (botuar në fletoren zyrtare korrik 2012).

Edhe këtë vit vlen të përmendet rritja e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në drejtim të inspektimeve të përbashkëta (3 subjekte financiare jobanka dhe 5 ZKV) si dhe trajnimeve të përbashkëta për subjektet ZKV dhe ato financiare jobanka për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

#### 4.2.4 TRANSPARENCA NDAJ PUBLIKUT

Transparenca dhe publikimi i informacionit kanë qenë gjatë vitit 2012 në fokus të vazhdueshëm jo vetëm nëpërmjet një procesi mbikëqyrës intensiv në vend, por edhe nëpërmjet analizave nga jashtë, duke synuar përmirësimin e standardeve të transparencës, mbrojtjen e klientit dhe forcimin e disiplinës së tregut.

Ndryshimet rregullative të vitit 2011, u shoqëruan me rritjen e angazhimit të bankave si dhe ndërmarrjen e një sërë hapash nga Banka e Shqipërisë për implementimin dhe përmbushjen e kërkesave të reja. Këto masa rezultuan efektive në ndërtimin e marrëveshjeve kontraktore duke u materializuar në kontrata të përforcuara në informacionin që i paraqesin klientit si dhe të drejtave që u delegojnë klientëve. Bankat nga ana e tyre kanë rritur vlerësimin e angazhimit për çështjet e transparencës dhe publikimit të informacionit. Megjithatë, vazhdojnë të evidentohen problematika kryesisht me përmbajtjen e kontratave të kredisë lidhur me normën e interesit dhe NEI-n. Në këtë kuadër, vërehen raste të përdorimit nga bankat të normës minimale të interesit me qëllim mbrojtjen nga ulja e normave bazë të interesit, apo edhe raste të përdorimit të indeksit të brendshëm në vend të indeksit orientues. Gjithashtu, mangësi janë vërejtur edhe në përputhshmërinë me kuadrin rregullator të transparencës për kredimarrësit e kredisë konsumatore e hipotekare. Megjithatë, bankat kanë shfaqur angazhim për të reaguar në kohë ndaj këtyre mangësive.

Për sa i takon publikimit të informacionit, në kuadër të masave të ndërmarra, rezulton se tashmë të gjitha subjektet financiare janë të pajisura me faqe zyrtare interneti me informacion për publikun. Mangësitë lidhen me mosprezencën e procedurave të brendshme mbi përgatitjen dhe publikimin e informacionit sipas standardeve dhe kërkesave rregullative në fuqi, vonesat në publikimin e raporteve vjetore dhe tremujore në web-in e tyre. Për këto mangësi, Departamenti i Mbikëqyrjes ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me bankat deri në marrjen e masave për disa prej tyre. Bankat përgjithësisht kanë krijuar standarde të kënaqshme lidhur me informacionin e publikuar në faqet e internetit. Megjithëse bankat janë përpjekur që informacioni i publikuar në ambientet e bankës dhe i ofruar nga shërbimi i klientit të jetë i qartë dhe i plotë, në disa raste vërehen mangësi në drejtim të pajisjes së klientit me informacionin parakontraktor.

E veçanta e këtij viti, është se për herë të parë, në 27 korrik 2012, ka filluar publikimi në faqen zyrtare të internetit të BSH-së, të raportimeve nga bankat të formateve standarde të miratuara, për komisionet dhe normat e interesit

për kreditë dhe depozitat. Në fazën e parë këto raportime iu nënshtuan një procesi verifikimi të plotësisë dhe saktësisë së të dhënave, për t'i paraprirë procesit të testimit dhe më tej publikimit final të informacionit të raportuar për çdo bankë, në modulën e krijuar në faqen zyrtare të internetit të BSH-së. Ky projekt ka si synim krijimin e kushteve të favorshme që klientët të informohen dhe të orientohen me lehtësi drejt zgjedhjeve më të përshtatshme në përputhje me situatën e tyre financiare. Krijimi i një sistemi raportimi të standardizuar nga Banka e Shqipërisë do t'i japë mundësinë kujtdo që ta konsultojë, me qëllim zgjedhjen e bankës më të përshtatshme për kërkesat e tij.

Gjithashtu, impakti i këtij projekti nga njëra anë do të krijojë lehtësi për konsumatorin (individ ose biznes), dhe nga ana tjetër është pikërisht ky i fundit që me reagimet tij, pritet të ndikojë në rritjen e nivelit të konkurrencës në treg dhe t'i orientojë bankat drejt uljes së kostove të produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë. Është e rëndësishme që klientët bankarë të jenë të informuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre kundrejt bankave, ashtu sikurse edhe të drejtat e detyrimet e bankave kundrejt tyre, informacion i cili është i disponueshëm nëpërmjet platformës informuese dhe rregullative që Banka e Shqipërisë ka vënë në dispozicion.

Mangësitë e identifikuara si dhe problematika që lidhet me një pjesë të portofolit të kredisë të disbursuar përpara ndryshimeve rregullatore të vitit 2011 kanë qenë shkaqe për ankesa nga klientët në Bankën e Shqipërisë, por edhe në vëmendje gjatë procesit mbikëqyrës në vend si dhe pjesë e rekomandimeve për çështjet e transparencës. Gjatë vitit 2012, Departamenti i Mbikëqyrjes ka trajtuar një sërë ankesash (rreth 56 raste) të ardhura në adresë të subjekteve të licencuara e mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë (kryesisht banka). Për një pjesë të madhe të tyre, zgjidhja e ankesës i përket organeve kompetente gjyqësore si dhe marrëdhënies përmbarim-bankë-gjykatë, pasi ajo është jashtë kompetencave të Bankës së Shqipërisë. Në rastet kur janë vërejtur mangësi apo parregullsi nga ana e bankave, ato janë adresuar me inspektime në vend apo edhe reagim shkresor nga Banka e Shqipërisë. Megjithatë çështjet e ngritura janë adresuar në kohë si ndaj subjekteve dhe klientëve.

Në fokus të procesit mbikëqyrës gjatë vitit 2012 kanë qenë edhe subjektet financiare jobanka. Këto subjekte vlerësohen të angazhuara për të përmbushur kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë për transparencën, megjithatë janë vërejtur mangësi që lidhen kryesisht me përmbajtjen e kontratave të nënshkruara me klientin, publikimin e normës efektive të interesit, metodologjinë e llogaritjes së normës së interesit, raportimin e raporteve vjetore në Bankën e Shqipërisë për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse.



## 5 REGJISTRI I KREDIVE

### 5.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Regjistri i Kredive në vitin e pestë të funksionimit të tij, si një mjet i rëndësishëm në duart e subjekteve bankare dhe financiare për administrimin optimal të rrezikut të kredisë, liston 27 subjekte pjesëmarrëse. Në fund të vitit 2012, subjektet bankare dhe financiare kanë raportuar në total 870,635 kredi në Regjistrin e Kredive nga të cilat 365,244 janë kredi aktive. Me pasurimin e Regjistrit të Kredive, me subjekte të tjera financiare të cilat kanë raportuar portofolin e tyre të kredive, në fund të vitit 2012 vërehet një rritje e numrit të kredive aktive të raportuara në sistem.

Viti	Kreditë e raportuara
Viti 2008	262,368
Viti 2009	291,137
Viti 2010	320,813
Viti 2011	349,350
Viti 2012	365,244

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabela 37. Numri i kredive aktive të raportuara në Regjistrin e Kredive.

Zgjerimi i Regjistrit të Kredive me subjekte të reja ndër vite, reflektohet dhe në përdorimin gjithnjë e më shumë të tij nga ana e subjekteve raportuese.

Viti	Kërkime në Regjistrin e Kredive nga subjektet raportuese
2008	88,875
2009	171,146
2010	198,229
2011	322,570
2012	333,549
<b>Viti 2012</b>	
Banka	247,549
Subjekte jobanka dhe USHKK	85,950

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabela 38. Numri i kërkimeve në Regjistrin e Kredive nga subjektet raportuese.

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme të punës së Regjistrit të Kredive zë edhe procesi i nxjerrjes së Raportit të kredimarrësit apo procesi i rishikimit të të dhënave të kredimarrësve, shërbim i cili kryhet nga punonjësit e Zyrës së Regjistrit të Kredive.

Tabela 39. Numri i kërkimeve për raporte kredimarrësish dhe i atyre për rishikim të dhënash pranë Bankës së Shqipërisë.

VITI	Kërkesa për raporte kredimarrësish	Kërkesa për rishikim
VITI 2008	139	34
VITI 2009	198	15
VITI 2010	368	13
VITI 2011	505	18
VITI 2012	417	16

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Informacioni i gjeneruar nga Regjistri i Kredive, përveç subjekteve bankare dhe financiare raportuese, i shërben edhe vetë Bankës së Shqipërisë për qëllime analize dhe inspektimi në vend. Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2012 është punuar për të shtuar gamën e raporteve të ndryshme që gjenerohen si në mënyrë periodike ashtu dhe rast pas rasti, në funksion të një procesi mbikëqyrës të rrezikut të kredisë në nivele sa më optimale.

## 5.2 PËRFSHIRJA E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA

Tashmë mundësinë për të patur një informacion shtesë të menjëhershëm e të besueshëm për klientët, që do të shërbejë në vendimarrjen për një kredi të caktuar apo të vlerësimit të performancës së tyre përgjatë kohëzgjatjes së kredisë, do ta ketë dhe një subjekt financiar jobankë. Në shtator të vitit 2012 u bë pjesë e sistemit të Regjistrimit të Kredive pas një periudhe testimi edhe subjekti jobankë: Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF sh.a.

Regjistri i Kredive ka ndjekur me intensitet dhe procesin testues të hedhjes së të dhënave nga subjektet kredidhënëse të cilat së shpejti priten të jenë pjesë e sistemit të Regjistrimit të Kredive, si dhe ka vijuar me vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe organizative të një prej subjekteve jobanka të licencuar për të kryer aktivitetin e kredidhënies, si dhe të dy shoqërive të kursim-kreditit të shkëputura nga unionet e tyre.

ANEKS 1. STRUKTURA E DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES



## ANEKS 2. PESHA SPECIFIKE E SECILËS BANKË NË SISTEMIN BANKAR

Dhjetor`12								
BANKAT	Totali i	Burimet e	Kapitali	Teprica	Kredi me	Bono	Letra me	Totali i
(Treguesi në %)	bilancit	përhershme	aksioner	e kredisë	probleme	thesari	vlerë	depozitave
Banka Raiffeisen	26.4	22.3	25.1	22.6	23.2	18.5	40.1	28.3
Banka e Bashkuar e Shqipërisë	0.5	1.1	1.3	0.3	0.8	0.7	-	0.5
Banka Veneto	1.4	2.2	2.5	2.2	1.3	0.5	-	1.2
Banka Kombëtare Tregtare	20.5	14.4	14.6	15.7	8.7	27.1	24.1	20.1
Banka Tirana	7.7	9.3	10.3	9.3	16.6	10.6	2.4	7.3
Banka Ndërkombëtare Tregtare	0.7	1.0	1.1	0.5	0.4	0.8	1.1	0.7
Banka Intesa SanPaolo Albania	10.7	12.3	13.0	8.5	10.4	11.9	16.7	10.8
Banka Procredit	3.4	4.2	3.5	4.2	2.6	3.6	0.3	3.2
Banka Credit Agricole - Shqipëri	2.6	4.1	3.2	4.0	6.1	0.9	-	1.7
Banka NBG Albania	3.1	3.6	2.4	5.1	7.6	3.6	1.0	3.1
Banka Alpha Albania	6.3	6.3	4.9	6.4	11.5	9.6	6.5	6.6
Banka e Parë e Investimeve	1.1	1.0	1.2	1.1	0.4	0.9	1.2	1.0
Banka e Kreditit të Shqipërisë	0.1	0.9	1.1	0.0	(0.0)	0.0	-	0.0
Banka Credins	7.8	10.0	8.0	11.8	6.6	3.6	0.4	7.9
Banka Societe Generale Albania	5.1	5.4	5.9	6.0	2.4	5.4	3.8	5.2
Banka Union	2.3	1.8	1.9	2.4	1.4	2.4	2.3	2.4
TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

## ANEKS 3. AKTIVET DHE PASIVET

AKTIVET (në milionë lekë)			
KODI	PËRSHKRIMI	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012
1	TOTALI I AKTIVEVE	1,120,168.08	1,187,983.36
11	VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	333,248.99	382,157.90
111	Mjete monetare	19,810.22	19,992.03
112	Marrëdhënie me Bankën Qendrore	91,213.65	102,229.32
1121	Rezerva të detyrueshme në Bankën Qendrore	85,915.94	91,686.39
1122	Të tjera	5,297.71	10,542.93
113	Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me B.Qendrore	104,620.91	96,199.10
1131	Bono thesari	104,620.91	96,199.10
1132	Bono të tjera të pranueshme për rifinancim	-	-
1133	Fonde rezervë për zhvlerësimin e bonove të përshtatshme për rifinancim nga BQ	-	-
114	Marrëdhënie me bankat, institut. e kreditit dhe instit. e tjera financiare	117,604.21	163,737.45
1141	Llogari rrjedhëse	8,052.87	26,581.62
1142	Depozita në banka, institucione krediti dhe inst. të tjera financiare	85,314.50	100,832.05
1143	Hua	22,512.56	35,268.50
1144	Të tjera	1,724.28	1,055.27
13	VEPRIMET ME KLIENTËT (Bruto)	561,682.08	573,507.24
131	Hua dhënë sektorit privat dhe individëve	529,829.83	545,000.35
1311	Hua afatshkurtër	156,760.14	162,085.00
1312	Hua afatmesme	116,334.96	114,453.43
1313	Hua afatgjatë	144,755.59	155,116.25
1314	Hua për prona të patundshme	111,235.50	113,101.94
1315	Kontrata qiraje	743.64	243.73
132	Hua dhënë administratës publike	1,535.13	1,587.94
1321	Llogari rrjedhëse	0.00	0.05
1322	Hua	1,535.13	1,587.89
1323	Llogari të tjera	-	-
133	Llogari të tjera të klientëve	30,317.12	26,918.96
14	VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË	244,172.00	256,682.22
141	Letra me vlerë me të ardhura fikse	234,929.99	252,849.08
142	Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	2,326.80	2,771.61
143	Letra me vlerë të blera & shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes	6,915.22	1,061.53
144	Kolaterali i paguar	-	-
145	Primet e marra	-	-
15	FONDE REZERVË TË KRIJUARA	(58,793.82)	(73,798.10)
151	Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (kryegjëja)	(53,686.82)	(70,860.85)
152	Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (interesi i përlllogaritur)	(1,371.57)	(1,208.57)
153	Fonde rezervë për investime	(3,735.43)	(1,728.68)
16	MJETE TË TJERA	13,799.52	21,402.93
161	Mjete të tjera	11,042.05	17,805.84
162	Veprimet si agjent	474.59	777.32
163	Llogari marrëdhëniesh	187.18	0.35
164	Llogari pezull, të diferencave dhe të pozicionit	2,042.71	2,792.90
1641	Llogari pezull	1,822.20	2,711.71
1642	Llogari pozicioni	220.51	81.18
165	Tatimi i vlerës së shtuar	52.99	26.53
17	MJETE TË QËNDRUESHME	13,869.16	15,895.23
171	Investime në pjesëmarrje	0.22	148.41
172	Filialet	301.90	301.90
173	Mjete të qëndrueshme (neto)	13,567.05	15,444.92
18	INTERESA TË PËRLLOGARITURA	12,190.14	12,135.95
181	Interesa të llogaritura (Klasa 1)	3,692.12	3,502.09
182	Interesa të llogaritura (Klasa 2)	4,535.05	4,308.71
183	Interesa të llogaritura (Klasa 3)	3,962.97	4,325.15
A	Totali i aktiveve në valutë	616,432.93	665,671.51
B	Totali i aktiveve të jorezidentëve	183,261.74	249,885.91

PASIVET (në milionë lekë)			
KODI	PËRSHKRIMI	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012
1	TOTALI I PASIVEVE	1,120,168.08	1,187,983.36
11	VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	72,127.43	64,231.44
111	Banka Qendrore	1,760.85	308.18
112	Bono thesari & bono të tjera të pranueshme	25,430.51	21,767.89
113	Llogari rrjedhëse	2,957.75	3,328.98
114	Depozita nga bankat, institucionet financiare	16,274.84	16,921.96
115	Hua	24,254.33	20,512.38
116	Të tjera	1,449.15	1,392.04
12	VEPRIME ME KLIENTËT	911,209.61	978,087.64
121	Administrata publike	5,219.31	6,206.43
1211	Llogari rrjedhëse	4,193.59	4,823.56
1212	Depozita pa afat	0.93	-
1213	Depozita me afat	591.90	723.04
1214	Hua	432.90	659.82
1215	Të tjera	-	-
122	Sektori privat	905,990.30	971,881.22
1221	Llogari rrjedhëse	133,225.56	143,763.71
1222	Depozita pa afat	41,933.48	45,155.72
1223	Depozita me afat	718,881.65	770,749.19
1224	Të tjera	11,949.61	12,212.59
1225	Certifikata depozitash	-	-
13	VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	333.73
131	Borxhe të përfaqësuara nga letrat me vlerë	-	-
132	Letra me vlerë të blera dhe të shitura me REPO	-	-
133	Garanci për veprime me letrat me vlerë	-	-
134	Prime për instrumentet financiare	-	333.73
14	DETYRIME TË TJERA	10,164.68	11,308.58
141	Detyrime të tjera	5,361.07	4,821.12
142	Veprimet si agjent	2,230.66	2,697.45
143	Llogari marrëdhëniesh	238.82	7.94
144	Llogari pezull të diferencave dhe pozicionit	2,325.78	3,776.52
1441	Llogari diferencash	2,308.19	3,775.87
1442	Llogari pozicioni	17.59	0.65
145	Tatimi i vlerës së shtuar = (form. 21) 46	8.35	5.54
15	BURIMET E PËRHERSHME	113,395.55	120,061.34
151	Ndihma dhe financimi publik	13.96	15.86
152	Fonde rezervë specifike	6,965.57	7,345.81
1521	Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	6,487.32	6,741.77
1522	Fonde rezervë specifike	478.25	604.04
153	Borxh i varur	9,111.31	10,858.58
154	Kapitali i vet i aksionerëve	97,304.71	101,841.10
1541	Kapitali i paguar	82,803.92	92,356.59
1542	Primet e aksioneve	4,180.10	4,657.76
1543	Rezervat	13,639.57	9,558.72
1544	Diferencë rivlerësimi	2,292.00	1,991.28
1545	Fitimet e pashpërndara ose humbja	(6,317.15)	(10,491.82)
1546	Fitimi (humbja) i vitit në vazhdim	706.27	3,768.57
16	INTERESA TË PËRLOGARITURA	13,270.81	13,960.63
161	Interesa të llogaritura (Klasa 1)	315.97	275.30
162	Interesa të llogaritura (Klasa 2)	12,852.50	13,581.69
163	Interesa të llogaritura (Klasa 3) = (form. 21) 339 + 3429	-	-
164	Interesa të llogaritura (Klasa 5)	102.34	103.65
A	Totali i Pasiveve në Valutë	581,435.64	624,686.30
B	Totali i Pasiveve jorezident	76,257.62	80,174.34

## ANEKS 4. TREGUESIT BAZË FINANCIARË

(në përqindje, në rast se nuk specifikohet ndryshe)				
Treguesit	Qershor'10	Dhjetor'10	Qershor'11	Dhjetor'11
Bazuar në kapital				
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik	16.21	15.38	14.64	15.56
Kapitali bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik	15.43	14.52	13.57	14.30
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	8.87	8.59	8.04	8.08
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	9.30	9.10	8.70	8.80
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	9.60	9.40	8.60	8.70
Kredi me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator bazë	32.81	38.08	51.17	56.61
Kredi me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator	31.24	35.95	47.43	52.01
Kredi me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner	30.32	34.80	47.62	52.64
Kthimi nga kapitali	8.31	7.58	1.22	0.76
Pozicioni i hapur në monedhë të huaj ndaj kapitalit rregullator bazë	7.64	5.33	4.02	4.29
Pozicioni i hapur në monedhë të huaj ndaj kapitalit rregullator	7.27	5.03	3.73	3.94
Pozicioni i hapur në monedhë të huaj ndaj kapitalit aksioner	7.06	4.87	3.74	3.99
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	42.47	43.54	43.77	43.88
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra	32.85	30.62	30.24	33.15
Kthimi nga aktivet	0.79	0.72	0.11	0.07
Kredi me probleme ndaj totalit të kredive	12.21	13.96	17.00	18.77
E ardhura neto nga interesi ndaj të ardhurës bruto	116.16	118.86	146.64	147.74
Shpenzimet e veprimtarisë ndaj të ardhurës bruto	73.61	75.50	88.39	91.29

## ANEKSI 5. TË DHËNAT PËR AKSIONERËT E BANKAVE

Nr.	Bankat	Aksionerët	Pjesëmarrje në kapital	Pronësia	Origjina e kapitalit	Vendi i origjinës
1.	Banka Raiffeisen	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH	100%	Private	I huaj	Austri
2.	Banka Kombëtare Tregtare	Çalik Finansal Hizmetler A.S.	100%	Private	I huaj	Turqi
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Banka Islamike e Zhvillimit (IDB) Jeddah	86.70%	Private	I huaj	Arabi Saudite
		Ithmaar Bank (ish Shamil Bank of Bahrein)	4.63%	Private	I huaj	Mbretëria e Bahreinit
		Dallah Albaraka Holding	2.32%	Private	I huaj	Arabi Saudite
		Business Fokus SDN BHD	1.47%	Private	I huaj	Arabi Saudite, Malajzi
4	Banka Intesa Sanpaolo Albania	Individë	4.88%	Individ	I huaj	Arabi Saudite
		Intesa Sanpaolo S.p.A (ISP)	98.61%	Private	I huaj	Itali
5	Banka Tirana	Shoqëria Italiane për Ndërmarrjet e Huaja S.p.a (SIMEST)	1.39%	Private	I huaj	Itali
		Piraeus Bank	98.48%	Private	I huaj	Greqi
6	Banka NBG Albania	Tzivelis Ioannis	1.52%	Individ	I huaj	Greqi
7	Banka Alpha Albania	National Bank of Greece	100.00%	Private	I huaj	Greqi
8	Banka Veneto	Alpha Bank, Greece	100.00%	Private	I huaj	Greqi
9	Banka Procredit	Veneto Banca Holding	100.00%	Private	I huaj	Itali
10	Banka Ndërkombëtare Tregtare	ProCredit Holding A.G.	100.00%	Private	I huaj	Gjermani
11	Banka Ndërkombëtare Tregtare	Financial Group ICB Holding	100.00%	Private	I huaj	Zvicër
12	Banka Credit Agricole Shqipëri	IUB HOLDING A.S, FRANCE	100.00%	Private	I huaj	Francë
13	Banka e Kreditit të Shqipërisë	3 individë	100.00%	Individ	I huaj	Kuvajti
13	Banka Credins	15 individë	71.92%	Individ	Vendas	Shqipëri
		B.F.S.E. Holding B.V.	20.19%	Private	I huaj	Holandë
		Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike (SECO)	2.89%	Publike - Private	I huaj	Zvicër
		Unioni Shqiptar Kursim-Kredi	5.00%	Private	Vendas	Shqipëri
14	Banka Societe Generale Albania	SOCIETE GENERALE	88.64%	Private	I huaj	Francë
		8 individë	11.36%	Individ	Vendas	Shqipëri
15	Banka Union	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	12.50%	Private	I huaj	Angli
		Unioni Financiar i Tiranës	83.13%	Private	Vendas	Shqipëri
		2 individë	4.38%	Individ	Vendas	Shqipëri
16	Banka e Parë e Investimeve, Albania	First Investment Bank, Bulgaria	100.00%	Private	I huaj	Bullgari



ANEKS 6. SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E DEGËVE  
DHE AGJENCIVE BANKARE BREnda TERRITORIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SIPAS PREFEKTURAVE, DERI  
NË VITIN 2012

Nr.	Prefekturat	VITI 2012	VITI 2011	VITI 2010	VITI 2009	VITI 2008	VITI 2007
1	Tiranë	218	212	210	210	208	161
2	Durrës	55	54	54	51	46	36
3	Fier	43	44	44	45	43	32
4	Elbasan	30	30	30	29	28	23
5	Korçë	37	37	38	38	37	30
6	Shkodër	25	25	25	24	23	17
7	Vlorë	42	41	41	39	38	32
8	Lezhë	25	26	25	26	26	21
9	Berat	21	21	20	21	21	14
10	Gjirokastër	23	24	24	24	25	20
11	Kukës	9	10	9	9	8	6
12	Dibër	10	10	9	8	8	7
	TOTALI	538	534	529	524	511	399

## ANEKS 7. LISTA E RREGULLOREVE TË MBIKËQYRJES BANKARE NË FUQI, DERI NË DHJETOR 2012

1. Rregullorja "Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal, për veprimtaritë e lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 22.04.1999.
2. Rregullorja "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", miratuar me vendimin nr. 58, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës: nr. 86, datë 07.11.2001; nr. 72, datë 11.09.2002; nr. 30, datë 16.04.2003; nr. 82, datë 08.10.2003; nr. 22, datë 24.03.2004; nr. 46, datë 08.06.2005; nr. 07, datë 31.01.07; nr. 63, datë 29.08.2008; nr. 89, datë 22.12.2010; dhe me vendimin nr. 63, datë 14.09.2011.
3. Udhëzimi "Për kapitalin rregullator", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimet: nr. 21, datë 24.03.2004; nr. 45, datë 08.06.2005; dhe nr. 70, datë 12.09.2006 të Këshillit Mbikëqyrës.
4. Rregullorja "Për rreziqet e tregut", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 02.06.1999, ndryshuar me vendimin nr. 98, datë 19.12.2001.
5. Udhëzimi "Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 05.07.2000.
6. Rregullorja "Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 06.06.2001.
7. Udhëzimi "Për certifikatat e depozitave", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 03.10.2001.
8. Manuali i veprimeve korrigjuese ndaj bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 26.06.2002.
9. Rregullorja "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.02.2002 dhe ndryshuar me vendimin nr. 09, datë 12.02.2003 dhe vendimin nr. 55, datë 12.09.2012.
10. Rregullorja "Për administrimin e rrezikut operacional", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 19.01.2011.
11. Rregullorja "Për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 15.06.2011.
12. Udhëzimi "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 69, datë 30.07.2003.
13. Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.09.2011.
14. Rregullorja "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin nr. 43, datë 08.06.2005 dhe ndryshuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës: nr. 68, datë 13.09.2006, dhe nr. 65, datë 29.09.2010.
15. Sistemi raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unioneve të tyre, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 08.06.2005.
16. Rregullorja "Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë

- elektronike", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30.03.2005.
17. Rregullorja "Për mbikëqyrjen e konsoliduar të bankave", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 68, datë 28.07.2005.
  18. Rregullorja "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 03.05.2006.
  19. Sistemi Raportues i Unifikuar për degët e bankave të huaja, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 15.10.2007.
  20. Rregullorja "Për licencimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 06.06.2007 dhe ndryshuar me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007 dhe vendimin nr. 82, datë 14.12.2011.
